

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7316 E diel 8 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ARIAN GALDINI

Spanja nuk është Serbi e as Katalonja nuk është Kosovë!



Dje

në "Deutsche Welle"

Nga CHRISTOPH STRACK

Deklarata është dramatike. Robert Vehrkamp flet në lidhje me zgjedhjet në Bundestag për një "linjë të re konflikti të demokracisë midis skeptikëve...

Europa dhe lufta për shtresën e mesme

Gjithmonë pas ideve dhe lëvizjeve të mëdha janë fshehur financime dhe interesat të mëdha. Interesat dhe financimet nuk janë domosdoshmërisht të këqija, ...
Vijon në faqen 21

Vijon në faqen 22



Operacioni antiterror, arrestohen 8 vetë

Dyshimi për lidhje me ISIS-in, policia prangos pedagogun shqiptar në Malajzi

Mister identiteti i 35-vjeçarit. Mediat: Kishte qëllim nxitjen e konfliktit fetar

Një shqiptar 35-vjeçar për të cilin mediat e huaja shkruajnë se është pedagog në një universitet publik në Shqipëri është arrestuar në Malajzi, pasi akuzohet se ka lidhje me grupin terrorist ISIS në Siri dhe në Irak. Ai u vë në pranga në kuadër të një aksioni ...

Në faqen 11

LISTA/ STRUKTURA E RE E QEVERISE, 6 MINISTRA DO KENE NGA 4 ZEVENDES

EMRAT, 33 ZV.MINISTRAT E "RAMA 2", 4 NGA KOSOVA

Gramoz Ruçi ikën nga sekretar i PS, ngjitet Taulant Balla. Rama sulmon drejtoritë që ka pasur LSI. Reagon Kryemadhi: Kriminelët që ke në krah s'të mbrojnë dot



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë punimeve të Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste

Në faqet 2-3

INTERVISTA

Dhuna ndaj gruas, flet vjehrra: Nuk e përkrah djalin, nuk e përzë nusen

Në faqen 8

ANALIZA E ZGJEDHJEVE

PD publikon një udhëzim të ri: Identifikim kush ka blerë votat

Në faqen 4

DESHMIA

Përplasja me policinë, i riu në gjiq: Unë isha me "Audin" e blinduar

Në faqen 9

SA DO TE PAGUANI

Projekti, taksa për shtëpi në bazë të çmimit të referencës

Në faqen 5

HORROR NE RRUGE



Drama, shkëmbi mbi makinë vret 2 vëllezër dhe gruan shtatzënë

Në faqen 8



Irakli Koçollari sjell studimin për veprën e panjohur të Mihal Ortodoksit

Një piktor nga Vlora në Rilindjen italiane

Në brendësi: Dritëro Agolli përballë socializmit. In memoriam Robert Elsie

Nga IRAKLI KOÇOLLARI

Më 28 qershor 2011 në Kastello Pikolomini të Çelanos u hap një ekspozitë me temë: "Rilindja vallzuese - Michele Greco da Valona (Mihal Ortodoksi nga Vlora) dhe piktorët e Adriatikut mes Abrucos dhe Molises". Sig-



urisht, kjo ishte një ngjarje e veçantë dhe mjaft domethënëse që bëri të njohura punët e mrekullueshme të një mjeshtri shqiptar të penelit, të panjohur gjer më tani. Prezantimi i artistit shqiptar, Michele Greco da Valona ishte ...

Suplement

ASAMBLEJA E PS EMERIMET

6 ministri do të kenë nga 4 zëvendës, Artan Shkreli në ministrinë e Gjyknurit

Qeveria "Rama 2" me 33 zv.ministra, 4 prej tyre vijnë nga Kosova

Qeveria "Rama 2" do të ketë në nivelin e dytë të drejtimit plot 33 zv.ministra. Emrat u bënë publikë dje, nga kryeministri Rama, dhe mes tyre u rikonfirmuan, Petro Koçi te Mbrojtja, Rovena Voda në Ministrinë e Brendshme, Mira Rakaçolli dhe Bardhylka Kospiri në Ministrinë e Shëndetësisë. Po ashtu Erjon Luçi do të vijojë në Ministrinë e Financave. Ajo që ra në sy është përfshirja e katër emrave nga Kosova, Valbona Shujaku, Besa Shahini e Hajrullah Çeku, dhe tjetra Dajna Sorensen, shqiptare e martuar me një qytetar danez. Ministrinë me më shumë zëvendësministra janë Ministria e Financave, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministria e Brendshme, ajo e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit.

ZV/MINISTRAT

NË MINISTRINË E BRENDSHME

- Rovena Voda
- Julian Hodaj
- Romina Kuko
- Besfort Lamallari

NË MINISTRINË E FINANCVE DHE EKONOMISË

- Elton Haxhi
- Albana Shkurta
- Erjon Luçi
- Dajna Sorensen

NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

- Enis Aliko

■ Hantini Bonati

- Dorina Çinari
- Artan Shkreli

NË MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

- Dhimo Kote
- Ermira Rusi
- Ilir Hallilaj
- Roland Kristo

NË MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT

- Ornela Çuçi
- Hajrudhah Çeku do të mbulojë turizmin

NË MINISTRINË E ARSIMIT,

SPORTIT DHE RINISË

- Besa Shahini
- Ervin Demo
- Kostandin Shkurti do të mbulojë fushën e sportit
- Shpati Kolgega do të mbulojë pjesën e rinisë

NË MINISTRINË E SHËNDËTËSISË

- Mira Rakaçolli
- Bardhylka Kospiri
- Ilirjana Bajraktari
- Ardjana Jaku

NË MINISTRINË E DREJTËSISË

- Toni Gogu
- Teuta Vodo

NË MINISTRINË E MBROJTJES

- Petro Koçi

NË MINISTRINË E EVROPËS DHE PUNËVETË JASHTME

- Klea Maliqi do të mbulojë integrimin
- Artemisa Dralo përfaqësuese e minoritetit
- Eijlen Xhafaj do të mbulojë diplomacinë ekonomike

NË MINISTRINË E KULTURËS

- Valbona Shijaku, nga Prishtina



Asambleja Kombëtare e PS-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Institucioni i Presidencës

NJOFTIM PER SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANE KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.93/2017, shpall vendet vakante për pozicionet e **keshilltareve ligjore dhe ekonomike** per institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4)**.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatese, pranë institucionit të KPK-se në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga

institucioni përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: komisionipavarurikualifikimit@gmail.com; tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomike)** te ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.



Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama dhe ministrat e kabinetit bënë dje një prezantim të programit të 100 ditëve të para të qeverisjes. Rritje ekonomike deri në 5.5% deri në fund të mandatit, luftë krimit dhe kultivuesve të kanabisit, veting në polici janë disa nga shtyllat kryesore të asaj çfarë kjo qeveri pretendon të realizojë. Gjatë fjalës së tij, në Asambledhë Kombëtare të PS-së, pas prezantimit të të gjithë ministrave, kreu i qeverisë, Edi Rama nuk la pa një mesazh edhe ish-aleatët e LSI-së, duke i cilësuar si "llum" sektorët ku ata kanë drejtuar si hipotekat e burgjeve. "Në këtë fazë të parë të mandatit tonë na duhet pastrim në të gjitha nivelet. Pastrim fizik në rrugë, në institucione, në zyrat e shërbimeve, pastrim në të gjitha nivelet e administratës nga keqbërësit dhe fillimi i një lufte të hapur ndaj korrupsionit të trashëguar", tha dje Rama. Sipas tij, "lufta kundër kanabisit nuk mbaron me ndalimin e kultivimi masiv të tij, por hyn në një fazë të re me përndjekjen e rrjeteve kriminale dhe sigurisht, jo vetëm të rrjeteve kriminale që janë të lidhura në një mënyrë ose në një tjetër me këtë veprimtari kriminale, por të të gjithë atyre 'të fortëve' që janë mësuar të bëjnë ligjin nëpër feude të ndryshme në periferitë e qendrave urbane". Sa i përket debatit me opozitën për përfshirjen e të gjithë biznesit në skemën e TVSH-së, Rama tha: "Nuk është një hap për të varfëruar, për të cenuar, për të penguar, për të bllokuar, për të mbyllur biznesin e vogël. Ne do ta bëjmë këtë betejë deri në fund. As nuk diskutohet që duke filluar nga viti i ardhshëm, çdo biznes në Republikën e Shqipërisë do funksionojë me TVSH", tha Rama.

KRITIKAT
"Në këto 100 ditë do të fillojë një betejë pa kompromis për të gjithë zullumin në shërbimet e transportit në Republikën e Shqipërisë, duke bërë një reformë të thellë, duke e çliuar ministrinë dhe në këtë aspekt, të gjitha ministratë do të çlirohen nga barra për të dhënë licenca dhe autorizime. Nuk është detyrë e ministrive kjo dhe duke çuar përpara përgjegjësisë, ata që e kthyen shërbimin e transportit në Republikën e Shqipërisë në një nga zullumet më të mëdha, ata të cilët kanë dhënë me qindra dhe me mijëra patenta jashtë çdo kriteri dhe ligji", tha Rama duke kritikuar kështu LSI-në. "Praktikisht kanë pajisur me armë, njerëz që mund të kthehen nga momenti në moment në vrasës, për shkak se nuk janë në gjendje ta drejtojnë mjetin brenda të gjitha standardeve dhe njohurive që duhen", tha ai. Rama lajmëroi se, "jemi në kushte të një krize hidrike shumë të rëndë, por as nuk kemi lejuar

Asambleja e PS, qeveria prezanton programin e 100 ditëve: Jemi në krizë hidrike

Rama shigjeton drejtoritë e LSI: Llum kriminal në burgje e hipoteka

"AKU, një bandë shtetërore. Jo më emërime partiake"



Fatmir Xhafaj

Monika Kryemadhi

"Do të nisim vetingun në radhët e policisë brenda 100 ditëve të para", tha dje ministri i Brendshëm. "Lufta kundër krimit të organizuar është sfida kyçe për gjithë mandatin, por në këto 100 ditët do të shohë një sërë hapash që do të hidhen. Një raport zyrtar i monitorimit kombëtar të kanabisit do të jetë shumë shpejt publik", u shpreh ai.

Kryetarja e LSI-së iu përgjigj dje kryeministrit gjatë një takimi me strukturat në Pogradec. "Kriminalët që Edi Rama ka zgjedhur për t'u pasur në krah nuk kanë për ta mbrojtur dot. Epoka e sundimit të krimit të organizuar do të marrë fund. Më mirë të kesh një infermiere, një këngëtar, një mësues, një shtëpiake, një pensionist dhe një të papunë për ta pasur në krah, se sa një vrasës. Edi Rama mund të qeverisë shtëpinë e tij me kriminelët, por Shqipërinë jo", tha Kryemadhi.

Leskaj

Ish-nënkryetarja e Kuvendit, Valentina Leskaj u rivotua dje për të qenë pjesë e kryesisë dhe Asamblesë së PS-së. Së bashku me të, pjesë e Asamblesë u bënë ish-ministrja Milena Harito dhe ish-deputeti Spartak Braho, i cili tashmë i është bashkëngjitur PS-së.

Ruçi

Gramoz Ruçi la dje postin e sekretarit të përgjithshëm në PS, për shkak të postit që mban si kryetar i Kuvendit. Vendin e tij tashmë e zuri Taulant Balla, i cili mban njëherësh edhe kreun e grupit parlamentar të PS-së.

Tahiri

Drejtuasi i Platformës së Bashkëqeverisjes me Qytetarët, Saimir Tahiri theksoi: "Të bindim njerëzit për të na vënë në provë dhe kësaj radhe të ndërtojmë besimin tek të gjithë. Kjo s'bëhet nga zyrat, as nga shkresat".

Sekretari organizativ paraqet analizën: Rezultat i dobët në 120 njësi nga 383

Fino: 10 kryetarë të PS në qarqe të dorëhiqen brenda 10 ditëve



BESA SHAHINI

Zëvendësimin e re e Arsimit, ka reaguar me një status në "Facebook" pas emërimit në këtë post nga kryeministri Edi Rama. "Kryeministri Rama sot më emëroi zëvendësimin të Arsimit në qeverinë shqiptare. Ndiem e nderuar që puna ime e deritanishme në fushën e arsimit verësohet si aset në qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Shpresoj që kontributi im të çojë të përmirësimi i mëtejshëm i shkollave dhe arsimit në Shqipëri", - tha Shahini.

Sekretari organizativ i PS-së, Bashkim Fino u kërkoi dje dorëheqjen brenda 10 ditëve, 10 kryetarëve të PS-së në qarqe, atje ku rezultatet e PS-së ishin më të dobëta në zgjedhjet e 25 qershorit. Në raportin e lexuar para asamblesë, Fino u shpreh: "Ka rreth 120 njësi administrative, në raport me 383 njësi administrative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ku ne kemi dalë dobët, që do të thotë se kemi dalë me më pak vota si Partia Socialiste në krahasim me 2013. Më duhet t'i u them që sot 10 kryetarë partie nuk janë funksionarë, pra kanë pretenduar dhe pretendojnë se janë në pozicione të ndryshme shtetërore. Unë u bëj thirrje atyre që brenda 10 ditëve të japin dorëheqjen. Ta lëshojnë partinë, të bëjnë zgjedhje të reja në ato bashki", u shpreh Fino. "Kryetarët e Partisë në i duam 24 në 24 orë në zyrat

e partisë, në punët e partisë, në krye të punëve të partisë, me strukturat e partisë", tha Fino. "Nuk mundesh dot të bësh një detyrë në dy karriqe dhe në dy zyra, të jesh edhe prefekt edhe drejtor, edhe kryetar i partisë së njësisë. Prandaj si sekretar organi-

zativ në funksion të statutit, statuti ma njuh një të drejtë të tillë jo mua, por të gjithëve ju, që brenda 10 ditëve këta kryetarë partie duhet të japin dorëheqjen, që ne të na hapin dritën jeshile për të bërë zgjedhjet. Pasi të mbarojmë zgjedhjet e kry-

etarëve të organizatave dhe kryetarëve të njësisë, të hapim zgjedhjet dhe për kryetarët e partisë në ato njësi vendore, ku ata kanë dhe një mandat tjetër funksionar", tha dje Fino, duke krahasuar rezultatet në 61 bashkitë.

dhe as nuk do lejojmë që kjo krizë të përkthehet në ndërprerje të detyruar të energjisë për familjarët, apo për bizneset". Në lidhje me drejtorët e shkollave, kryeministri tha se ata nuk do të emërohen më siç i do partia. "Çuarja e tepsisë për skrap do të marrë 4 vjet, por fillimi i procesit është ndërkohë këtu, i nisur dhe ky proces do vazhdojë. Do vazhdojë edhe aty ku është llumi më i madh në Republikën e Shqipërisë, në

burgje dhe në hipoteka. Është llum kriminal dhe llum shtetëror. Burgjet janë sistemi ku shteti-llum është bërë bashki me llumin anti-shtet për vite e vite të tëra e që në katër vitet e shkuara, llumi ka arritur në nivele të papërfytyrueshme", tha Rama duke vijuar sulmin ndaj ish-drejtesve të LSI-së. "Nuk do ketë më asnjë emërim partie nëpër burgje. Nuk do ketë më asnjë veteriner, asnjë masazhator, asnjë këngëtar, që shkon dhe

punësohet si polic burgju. Kemi qenë në që kemi shkuar në fushatë e keni qenë ju, që u keni tundur zgjedhësve listat e bëra nga partia që kishe burgjet, duke u premtuar që po na dhatë votën, ja ku e keni vendin e punës. Mbusur listat me këngëtarë, me masa-zhatorë, me roje, me infermiere, me lloj-lloj njerëzish. Kemi gjetur këngëtarë dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Kuptohet, këngëtar të dështuar", u

shpreh Rama. Kryeministri lajmëroi pastrim edhe në bujqësi. "Për 100 ditë do zhvillojmë një luftë të paepur në të gjithë territorin kundër thertoreve. Jemi i vetmi vend që 'ther' në parlament e ther në rrugë", u shpreh Rama. "Pjesë e këtij procesi është edhe një përpjekje e fortë për të çliuar popullin fermer nga një bandë. Një bandë shtetërore që quhet AKU", u shpreh kryeministri, i cili lajmëroi një fazë të re edhe në shëndetësi.

Drejtuesit e PD-së për 8 javë do të analizojnë humbjen e zgjedhjeve

Udhëzimi i Bashës: Identifikoni ata që blenë votat në 25 qershor

"Strategji e brendshme kundër shitblerjes, vjedhjes së votës"

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha firmosi parajdjet, udhëzimin për nisjen e analizës së zgjedhjeve të 25 qershorit. Në bazë të këtij udhëzimi, për 8 javë me radhë degët do të zhvillojnë diskutime mbi 4 pika të mirëpërcaktuara, ku ndër të tjera është edhe analizi i rolit të figurave të tjera në fushatë, por edhe krahasimi i votave me zgjedhjet e shkuara. Fillimisht analiza do të nisë në bazë grup seksioni, për të vazhduar më tej me partitjen e të dhënave në kryesinë e degëve. Do të jetë grupi i punës që do të formulojë një raport përmbljedhës me gjetjet kryesore në terren të analizës, mbi funksionimin e partisë, ecurinë e fushatës dhe rezultatin e zgjedhjeve. Pas përfundimit të raportit, gjetjet do t'i dërgohen sekretariatit organizativ të PD-së.

Në pikën e parë të udhëzimit, në qendër të punës do të jetë analiza e detajuar e votave në çdo qendër votimi dhe verifikimi i të dhënave me zgjedhjet paraardhëse. Po ashtu, në sqyrtim do të merret edhe ndikimi i emigracionit dhe migrimit të brendshëm, ku do të verifikohen votuesit e qendrueshëm, ata që nuk dolën në zgjedhje, por edhe ato vota që PD-ja ua kaloi partive të tjera politike. Një tjetër pikë do të jetë edhe niveli i përfshirjes së strukturës dhe anëtarësisë në fushatë. Në këtë pikë kërkohet roli që kanë pasur figurat me potencial politik në PD dhe roli i të zgjedhurve vendor. Po ashtu do të verifikohet edhe angazhimi i komisionerëve, por edhe koordinimi me aleatët. Një pikë e tretë do të jetë edhe analizi i fushatës së kundërshtarëve. Për këtë kërkohet një vlerësim i parave të shpenzuara nga kundërshtarët politikë. Mënyra e përdorimit, strukturat e angazhuara kriminale apo jo si dhe burimi i parave. Po ashtu, strukturat e PD-së do të evidentojnë persona konkretë në atë që selia blu e konsideron shitblerje të votës. Në pikën 4 të udhëzimit parashikohet edhe dhënia e mendimit mbi përfshirjen e anëtarësisë në fushatë. Ndër të tjera, në udhëzimin e Bashës nënvizohet nisja e punës për reformën zgjedhore, ku deputetët përfshirjen në Kodin Zgjedhor të masave ndaj shitblerjes së votave dhe transparencës së financave të partive. Në dokumentin që u është shpërndarë të gjithë drejtuesit të PD-së thuhet se "manipulimi i zgjedhjeve të 25 qershorit ka rënduar krizën politike dhe shoqërore në vend dhe ka dëmtuar rëndë besimin e qytetarëve të sistemi ynë politik dhe, për rrjedhojë, ka ulur besimin e tyre tek e ardhmja



Kreu i PD-së, Lulzim Basha



Faksimile e udhëzimit të Bashës

REFORMA ZGJEDHORE

Në udhëzimin e Bashës nënvizohet nisja e punës për reformën zgjedhore, ku deputetët përfshihen në Kodin Zgjedhor të masave ndaj shitblerjes së votave dhe transparencës së financave të partive.

Ish-deputeti sqaron platformën për ringritjen e partisë

Patozi: S'kemi lëvizje anti-Basha, lidhshipi duhet t'i thërrasë arsyes

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Patozi sqaroi dje, platformën për "ringritjen e PD-së". Gjatë intervistës në emisionin "Kjo Javë" të gazetares Nisida Tufa në "News24", Patozi bën fajtor Lulzim Bashën për përkeqësimin e partisë. Patozi tha se shpreson që Basha, të arsyetojë dhe të jetë dakord me krijimin e platformës. "PD-ja përjetoi një krizë të thellë për shkak të humbjes së zgjedhjeve. Jo për shkak të rezultateve, por për shkak se si shkuam në zgjedhje dhe si u diskutua më pas për zgjedhjet. Ne kemi pasur një lidhship të gabuar që çdo ditë ka thelluar gabimet e tij, dhe kjo platformë kërkon që PD-ja të qëndrojë e bashkuar. Në PD është thyer besimi të lidhshipi prej traumës që shkaktoi në zgjedhje", - tha Patozi. Në lidhje me platformën, Patozi thotë se do



Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Patozi

të presin një përgjigje që uron të jetë pozitive, jo thjesht për lëvizjen, por për ringritjen e PD-së. "Nga kjo përgjigje varet fati i PD-së, dhe rrjedhimisht fati i Shqipërisë. Duhet të qëndrojmë të bashkuar dhe të ringritemi për të mposhtur kundërshtarin", - u shpreh Patozi. "Kjo nuk është lëvizje anti-Basha, por për të shëruar PD-në nga një traumë. Basha edhe vetë e ka pranuar që është përgjegjës për

humbjen. Basha duhet të rikthejë votën. Për fat të keq, Shqipëria sot është e varur nga vullneti i dy mashtruesve të mëdhenj politikë, Basha e Rama", - u shpreh ai. "Unë kam skepticizmin tim karshi përgjigjes së Bashës, pasi ky i fundit, ndryshe ka qenë në vitin 2013 e ndryshe tani, ka ardhur duke u përkeqësuar. Por ai mund t'i thërrasë arsyes", - theksoi ish-deputeti i PD-së.

veprimesh për të parandaluar dhe shmangur tjetërsimin e votës. Hartimi i kësaj strategjie kërkon identifikimin e të gjitha dobësive, hapësirave dhe instrumenteve të shfrytëzuara dhe të përdorura për të manipuluar dhe ndikuar në mënyrë të padrejtë votën, me qëllim propozimin e ndryshimeve dhe masave të nevojshme or-

ganizative, strukturore dhe vepruese të të gjitha strukturave të Partisë Demokratike që merren me procesin zgjedhor. Hartimi i strategjisë dhe planit duhet të bëhet me kontributin në ide dhe mendime të të gjithë anëtarëve, mbështetësve dhe drejtuesve të Partisë Demokratike në të gjitha nivelet", thuhet në hyrje të udhëzimit.



Zyrtarizohen sekretarët e përgjithshëm, Ndreca shkon te mjedisi, Bele tek arsimit

Ministrat e qeverisë "Rama 2" kanë zyrtarizuar më në fund emrat e sekretarëve të përgjithshëm sipas dikastereve që drejtojnë. Kështu, pas caktimit edhe të zvmministreve dje, në Asambledën e PS-së, u qartësua se Plarent Ndreca, nga Ministria e Arsimit do të kalojë në Ministrinë e Mjedisit. Në Ministrinë e Arsimit tashmë do të jetë Koli Bele, i cili ka lëvizur nga Ministria e Energjetikës. Në këtë të fundit shkon Gent Kerri. Arjan Kraja, ish-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes shkon në Ministrinë e Shëndetësisë.

SEKRETARËT E PËRGJITHSHËM TË QEVERISË:

- Ministria e Financave&Ekonomisë - Gelardina Prodana
- Ministria e Jashtme - Gazmend Barbullushi
- Ministria e Shëndetësisë - Arjan Kraja
- Ministria e Bujqësisë - Aurora Alimadhi
- Ministria e Mjedisit - Plarent Ndreca
- Ministria e Kulturës - Olti Musaka
- Ministria e Mbrojtjes - Alba Thoma
- Ministria e Arsimit - Koli Bele
- Ministria e Energjetikës - Gent Kerri
- Ministria e Drejtësisë - Elira Kokona

SHPLLJE ANKANDI

Shoqëria përmbarimore "Corrector" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, - Trull + Ndërtëse me sipërfaqe 116.2 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 55 m², ndodhur në Zonën Kadastrale 8562, Nr.Pasurie 2/966, Vol.31, Fq.105, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë; Cnimi i ankandit të tretë është EUR 45,360 (dyzetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro). Ankandi zhvillohet dt.30/10/2017, ora 16.00 në adresën, Rruga e Kavajës, Nderesa 27, Hyrja 1, Kati i III -të, Tiranë. Kontakt: cel. 0684000061, ose në adresën e email: armets.lole@nchb.al

TAKSAT E BANESAVE NDRYSHIMET

Ministria e Financave po përgatit taksimin e ri mbi pasuritë e patundshme

Ndryshon formula, taksa për shtëpi në bazë të çmimit të referencës

Tabela/ Ja çmimet e referencës për 32 zonat e Tiranës

Ornela Manjani

Formula për taksimin e shtëpive do të ndryshojë. Ministria e Financave po përgatit një draft, sipas të cilit taksa mbi pronën do të llogaritet në bazë të çmimit të referencës, i cili caktohet nga qeveria. Taksa e banesave që prej 1 janarit do të ndryshojë, dhe sipas llogaritjeve pritet të jetë më e lartë se ajo që aplikohet aktualisht. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se taksa e banesave tashmë do të mblihdet në bazë të vlerës, ndërsa do të paguajnë më shumë ata qytetarë që kanë më shumë se dy shtëpi. Si argument për ndryshimin e formulës që taksimit, është fakti se duhet të kalohet në një sistem të taksës mbi pasurinë, e cila bazohet në vlerë, që do të thotë se, ai që ka shtëpi më të mirë do të paguajë një taksë më të lartë. Ende nuk është vendosur sa do të jetë taksa e re, ndërkohë që sot paguhet nga 15 deri 30 lekë për m². Ndërkohë, rritje më të ndjeshme të taksës do të kenë ata qytetarë që kanë më shumë shtëpi. Ministria e Financave pret që taksa e pronës të arketohet në bazë të kadastrës fiskale, e cila do të regjistrojë të gjitha pronat e patundshme sipas vlerës së tyre.

ÇMIMET E REFERENCËS NË TIRANË

Çmimet e referencës për Tiranën variojnë, nga 60 mijë lekë për m² deri në 190 mijë lekë/m². Referuar tabelave, çmimi fiskal për shitblerjen e apartamenteve në zonën e Ish-Bllokut ka mbetur i pandryshuar. Çmimi i apartamenteve për këtë zonë do të vazhdojë të jetë 190 mijë lekë për metër katror. Sipas tabelave, rritje të çmimit fiskal për shitblerjen e apartamenteve kanë shënuar rruga "Bardhyl", Xhamlliku, Profarma, rruga "Kongresi i Manastirit" dhe bulevardi "Zhan Dark". Qeveria ka shtrenjtuar edhe çmimet e shitblerjeve të apartamenteve për "Rrugën e Durrësit". Në tabelë kjo përkon me zonën kadastrale 3/1, ku çmimi më parë ishte 75 mijë lekë për metër katror, ndërsa sot bëhet 77 mijë lekë për metër katror, me një rritje prej 2 mijë lekësh për metër katror. Çmimi i referencës për këtë zonë më parë ishte 100 mijë lekë për metër katror, ndërsa bëhet 102 mijë



NDRYSHIMET NE FORMULA
Ministria e Financave po përgatit një draft, sipas të cilit taksa mbi pronën do të llogaritet në bazë të çmimit të referencës, i cili caktohet nga qeveria. Taksa e banesave që prej 1 janarit do të ndryshojë dhe sipas llogaritjeve pritet të jetë më e lartë se ajo që aplikohet aktualisht.

ÇMIMET E REFERENCËS PËR TË GJITHA ZONAT NË TIRANË

Xhamlliku, Profarma, Rr. "Bardhyl", Rr. "Kongresi i Manastirit"	- 77.000 lekë/m ²
Porcelan, Kinostudio, Rr. "Hoxha Tasim", fshati Linzë	- 60.000 lekë/m ²
Kompleksi i Spitaleve, SHIK, Oxhaku, Allias, Tufinë	- 70.000 lekë/m ²
Rr. "Njazi Meka", Bregu i Lumit, Allias i Ri, "Myslym Keta"	- 60.000 lekë/m ²
Ish-Blloku, Libri Universitar, "Vodafon"	- 190.000 lekë/m ²
Stadiumi "Selman Stermasi", Liqeni Artificial	- 132.000 lekë/m ²
Kopshti Botanik, Rr. "Komuna e Parisit", Liqeni Artificial	- 107.000 lekë/m ²
Hotel "Diplomat", blloku "Vasil Shanto", Selitë e vogël	- 129.500 lekë/m ²
Shkolla Teknologjike, Kombinati, Vaqarr, Selitë, Yzberisht, Sharrë	- 65.000 lekë/m ²
Gjykata e Rrethit, ish-Ekspozita	- 72.000 lekë/m ²
Bar "Piazz", Blloku gjatë rrugës "Zogu i Parë", rr. "Fortuz" deri te "Mine Peze"	- 130.000 lekë/m ²
Stacioni i Trenit, Arkiva e Përgjithshme, Hipoteka	- 100.000 lekë/m ²
"Don Bosko", Fabrika e Këpucëve, Bregu i Lumit, Rr. "Siri Kodra"	- 77.000 lekë/m ²
PTT, Telekom, ish-Lidhja e Shkrimtarëve	- 145.000 lekë/m ²
"Myslim Shyri", Drejtoria e Policisë, Kisha Katolike	- 139.500 lekë/m ²
Ish-blloku i ambasadave, Prokuroria, "Rruga e Durrësit"	- 102.000 lekë/m ²
Ferluti, ish-uzina Tirana, Shkolla e Partisë	- 87.000 lekë/m ²
Laprakë, Drejtoria e Doganave, Bregu i Lumit, Fushë Mëzë, "Don Bosko"	- 70.000 lekë/m ²

lekë për metër katror, pra rritet 2 mijë lekë. Ndërsa për zonën 1/1, që përfshin "Ali Demin" dhe fshatin Shkozë, çmimi i vlerës të

tregut është ulur 300 lekë për metër katror. Nga 98 mijë lekë për metër katror, me udhëzimin e ri bëhet 97.700 lekë për metër katror.

Ulje modeste ka shënuar edhe çmimi i tregut të apartamenteve në zonën e 9-katësheve, prej 500 lekësh për metër katror.

Nr.	Qyteti	lekë / m ² sipërfaqe shfrytëzimi
1. Qarku Tiranë		
1	Tiranë	89,125
2	Vorë	51,500
3	Kamëz	51,700
4	Kavajë	56,384
5	Rrogozhinë	41,000
2. Qarku Durrës		
6	Durrës	68,540
7	Krujë	48,500
8	Shijak	41,066
9	Sukth	41,000
10	Fushë-Krujë	51,000
3. Qarku Shkodër		
11	Shkodër	58,000
12	Pukë	22,000
13	Vau Dejës	24,300
14	Koplik	40,500
15	Fushë - Arrëz	7,500
4. Qarku Vlorë		
16	Vlorë	59,400
17	Cërken	60,000
18	Selenicë	25,000
19	Himarë	56,000
20	Sarandë	53,300
21	Delvinë	26,750
22	Konispol	28,000
5. Qarku Korçë		
23	Korçë	45,816
24	Pogradec	49,956
25	Bilisht	35,000
26	Ersekë	26,673
27	Maliq	27,800
28	Leskovik	21,000
6. Qarku Fier		
29	Fier	53,030
30	Lushnjë	40,100
31	Ballsh	30,100
32	Patos	28,000
33	Divjakë	49,000
34	Roskovec	30,000
7. Qarku Berat		
35	Berat	41,000
36	Kuçovë	38,000
37	Poliçan	26,000
38	Corovodë	25,000
39	Ura - Vajgurore	37,300
8. Qarku Elbasan		
40	Elbasan	50,200
41	Librazhd	44,020
42	Cërrik	38,300
43	Gramsh	43,023
44	Peçin	39,070
45	Presnjas	41,780
46	Belsh	35,000
9. Qarku Gjirokastrë		
47	Gjirokastrë	47,860
48	Pëmet	36,867
49	Tepelenë	32,500
50	Mernaliaj	15,000
51	Kelcyre	24,600
52	Libohovë	28,400
10. Qarku Lezhë		
53	Lezhë	56,000
54	Lac	42,500
55	Mamurras	31,000
56	Reëshen	42,000
57	Rubik	29,500
11. Qarku Kukës		
58	Kukës	53,700
59	Bajram Curri	27,890
60	Kuçmë	24,500
12. Qarku Dibër		
61	Peshkopi	48,563
62	Burrë	43,357
63	Bulçizë	42,904
64	Klos	32,000
Komunat		
65	Komuna Shëngjin	55,000
66	Komuna Milot	34,200
67	Komuna Krrabë	28,200
68	Komuna Kashar	52,500
69	Komuna Dajt	53,000
70	Komuna Farkë	64,500



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

Programme: Climate Friendly Integrated Waste and Recycling Management

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The program CFIWM assists Albania to provide affordable and ecological services in the field of solid waste to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the Integrated Solid Waste Management strategy
 2. establishment of waste separation and composting
 3. increase of recycling and reduction of solid waste
 4. effective sector regulation and monitoring
- GIZ supports, in particular, the modernization of the solid waste management system in the Municipality of Himara. To strengthen our local capacities in Himara,

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Advisor to support the Municipality of Himara with the implementation of the Solid Waste Management Plan

At average, the advisor will work ¾ of her/his working time located in Himara and ¼ from the project office in Tirana.

A. Responsibilities

- Advisor to the Municipality of Himara, private and NGO stakeholders as well as the general public on the implementation of the new solid waste management plan (waste management technology, processes, management including financing and fees, monitoring and evaluation, documentation). The modernisation will focus on the introduction of solid waste separation at the source, increasing recycling, and treatment of organic waste.
- being the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff
- supporting the project manager with project steering
- innovation and knowledge management

The technical solid waste management expert performs the following tasks:

B. Tasks

1. Professional Advising and Consulting

- Supervises development and implementation of project plans and activities in close coordination with counter partners within the Municipality of Himara
- Contributes to preparation and implementation of the consultation process, the project's activities, and efforts in the Municipality of Himara
- Assists in defining terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project's activities, including educational campaigns Municipality of Himara
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the project's field of activities within the Municipality of Himara
- Advises partners and project colleagues as the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff and assists with the implementation of activities in these fields

2. Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts, dialogues: does PR work and cooperates with relevant organizations, international development partners, non-governmental bodies and persons within the program's/project's environment as well as with other projects in order to enhance and

maintain good working relationships

- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme

3. Knowledge management

- Assist in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Develops strategies and technical concepts including guidelines, manuals, and procedures, which are ready to be applied
- Prepares reports and presentation materials

4. Management and Coordination tasks

- Contributes to project planning/develops project designs, including preparation, organization and moderation of planning exercises, implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication, and documentation in regard to municipal services, cooperation with the private sector and human resource development
- Coordinates and prioritises relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and in the implementation of these activities within the Municipality of Himara
- Prepare the budget for project events within the Municipality of Himara

C. Required qualifications, competences and experience:

- masters or bachelor degree relevant to municipal or public service or in environmental/engineering sciences or extended professional working experience in or with the Albanian municipal or public service
- at least 5 years of work experience in a relevant area
- experience in municipal or public service provision or extensive work experience inside or with development partners
- Ability to support a multi-task, multi-discipline project team
- Fluency in written and spoken Albanian and good command of the English language; command of German language would be an additional asset
- Able to work in a team as well as independently
- High level of reliability
- A personality with excellent social and communication skills
- Clean driving licence for cars being a very reliable driver

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project offices in Himara and Tirana
- Assignment period: 01.11.2017 until 31.08.2019

Please forward your application until 19.10.2017 to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de in-cluding the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

Programme: Climate Friendly Integrated Waste and Recycling Management

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The program CFIWM assists Albania to provide affordable and ecological services in the field of solid waste to its population with an orientation at EU standards. In particular support is planned to the following four areas:

1. implementation and further development of the Integrated Solid Waste Management strategy
2. establishment of waste separation and composting
3. increase of recycling and reduction of solid waste
4. effective sector regulation and monitoring

GIZ supports, in particular, the modernization of the solid waste management system in the Municipalities of Peqin and Rrogozhina. To strengthen our local capacities in Peqin and Rrogozhina,

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Advisor to support the Municipalities of Peqin and Rrogozhina with the implementation of their Solid Waste Management Plans

At average, the advisor will work ¾ of her/his working time located in Peqin or Rrogozhina and ¼ from the project office in Tirana.

A. Responsibilities

- Advisor to the Municipalities of Peqin and Rrogozhina, private and NGO stakeholders as well as the general public on the implementation of the new solid waste management plans (waste management technology, processes, management including financing and fees, monitoring and evaluation, documentation). The modernisation will focus on the introduction of solid waste separation at the source, increasing recycling, and treatment of organic waste.
- being the project's focal person for (a) cooperation with the private sector as well as (b) human resource development for municipal staff
- supporting the project manager with project steering
- innovation and knowledge management

The technical solid waste management expert performs the following tasks:

B. Tasks

1. Professional Advising and Consulting

- Supervises development and implementation of project plans and activities in close coordination with counter partners within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Contributes to preparation and implementation of the consultation process, the project's activities, and efforts in the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Assists in defining terms of reference, selection, and supervision of contracted third parties in carrying out project's activities, including educational campaigns Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the project's field of activities within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Advises partners and project colleagues as the project's focal person for municipal administration and service provision in particular in the field of solid waste management

2. Communication and networking

- Co-operates with and ensures regular contacts, dialogues: does PR work and cooperates with

relevant organizations, international development partners, non-governmental bodies and persons within the program's/project's environment as well as with other projects in order to enhance and maintain good working relationships

- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme

3. Knowledge management

- Assist in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer
- Develops strategies and technical concepts including guidelines, manuals, and procedures, which are ready to be applied
- Prepares reports and presentation materials

4. Management and Coordination tasks

- Contributes to project planning/develops project designs, including preparation, organization and moderation of planning exercises, implementation, management, monitoring, quality management, evaluation, communication, and documentation in regard to municipal services, cooperation with the private sector and human resource development
- Coordinates and prioritises relevant project activities in cooperation with the partners, as well as in organizational preparation and in the implementation of these activities within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina
- Prepare the budget for project events within the Municipalities of Peqin and Rrogozhina

C. Required qualifications, competences and experience:

- masters or bachelor degree relevant to municipal or public service or in environmental/engineering sciences or extended professional working experience in or with the Albanian municipal or public service
- at least 5 years of work experience in a relevant area
- experience in municipal or public service provision or extensive work experience inside or with development partners
- Ability to support a multi-task, multi-discipline project team
- Fluency in written and spoken Albanian and at least a fair command of the English language; command of German language would be an additional asset
- Able to work in a team as well as independently
- High level of reliability
- A personality with excellent social and communication skills
- Clean driving licence for cars being a very reliable driver

Contract conditions:

- Full-time employment
- Project offices in Peqin or Rrogozhina and Tirana
- Assignment period: 01.11.2017 until 31.08.2019

Please forward your application until 19.10.2017 to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de in-cluding the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Raporti i Bankës së Shqipërisë zbardh vështirësitë e bizneseve

Ornela Manjani

BSH: Konkurrenca mbetet problemi kryesor për bizneset

Ulet kreditimi, shtrëngohen kushtet e huadhënies

Bizneset shqiptare kanë ngritur si shqetësim kryesor mungesën e konkurrencës dhe gjetjen e financimeve. Në vërtetimin e Bankës së Shqipërisë për gjendjen e ndërmarrjeve në 6 muajt e parë të këtij viti, konstatohet se ka pasur një përqendrim të konkurrencës, të gjetjes së tregjeve dhe financimeve. Ndërmarrjet shqiptare ankohen se po vuajnë mungesën e konkurrencës, gjetjen e tregjeve dhe mundësive për financim. Këto gjetje janë publikuar në raportin e Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë për 6 muajt e parë të 2017-ës.

VROJTIMI

Vrojtimi i bërë ka nxjerrë në pah se gjatë pjesës së parë të vitit 2017, konkurrenca është përqendruar në krahasim me një vit më parë dhe vijon të konsiderohet nga të gjitha grupet e ndërmarrjeve si problemi kryesor në aktivitetin e tyre. Gjetja e tregut për shitjen e produkteve gjithashtu vlerësohet si një tjetër faktor i rëndësishëm kufizues për të tre grupet e ndërmarrjeve, por veçanërisht më e ndjeshme është për kompanitë e vogla dhe të mesme. Po ashtu edhe problematikat lidhur me aksesin në financim janë vlerësuar në rritje për ndërmarr-


jet e vogla, ndërsa kostot e financimit janë vlerësuar në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Ecuria e shitjeve vlerësohet në rënie për ndërmarrjet e vogla, ndërsa është pozitive për

ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla ngrenë si shqetësim edhe ngarkesën e borxhit, ku rreth 24.3% e tyre deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se

vlera e kapitalit. Më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se nuk ka asnjë mundësi që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmuorin e ardhshëm.

zë kredia për biznesin rezident, me 85%. Kjo e fundit u tkurr si në terma gjashtëmuorë ashtu edhe vjetorë, me përkatësisht 3.0% dhe 5%. Gjatë periudhës, tkurrja më e madhe ndodhi në tepriçen e kredisë për "kapital qarkullues" dhe "blerje pajisjesh". Ndërsa, zhvillimet vjetore flasin për një rënie të stokut të kredisë edhe në kategorinë "investime për pasuri të paluajtshme". Në të kundërt, teprica e kredisë për bizneset jorezidente u zgjerua me 15.5% ndaj një viti më parë dhe rreth 2.1% gjatë periudhës. Në strukturën e kredisë totale për bizneset, pesha e kredisë në lekë është rritur, përkundër rënies së kredisë në valutë. Pesha e kredisë në valutë në totalin e kredisë së bizneseve zbriti në 62.2%, ose 2.1 pp më pak se një vit më parë. Sipas raportit, rënie ka shënuar edhe teprica e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit, ndonëse pesha e saj në totalin e kredisë për bizneset ka mbetur pranë nivelit 26%. Në strukturën e kredisë së pambrojtur të bizneseve, peshat e kredisë "për tregti", "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" dhe "për zhvillim biznesi" ranë përkatësisht në 46.3%, 9.0% dhe 10.0%.

Grafik 4.4 Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar

STRUKTURA

Në strukturën e kredisë së pambrojtur të bizneseve, peshat e kredisë "për tregti", "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" dhe "për zhvillim biznesi" ranë përkatësisht në 46.3%, 9.0% dhe 10.0%.

KREDIA

Kredia për bizneset përbën 66% të tepriçës së kredisë dhënë nga sektori bankar dhe regjistron një rënie të lehtë vjetore. Brenda këtij portofoli, peshën kryesore e

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Shkëputja dyshohet se u shkaktua nga rrëshqitjet e dherave

Shkëmbi shkëputet nga mali dhe bie mbi makinë, vdesin 2 vëllezër e gruaja shtatzënë



Vendi ku ndodhi ngjarja

LEZHË - Dy vëllezër dhe bashkëshortja e njërit prej tyre humbën jetën dhe një ngjarje tragjike të ndodhur në Torovicë të Lezhës, kur një masiv shkëmbor u shkëput nga mali dhe zuri poshtë mjetin me të cilin ata shinin duke udhëtuar. Burime pranë policisë bënë me dije se makina tip fuoristradë "Land Rover" ishte duke lëvizur në aksin Lezhë-Torovicë, kur u godit nga masivi shkëmbor që u rrokullis për një distancë më shumë se 200 metra nga vendi ku u shkëput. Menjëherë në vendin e ngjarjes mbërritën forca të shumta policie si dhe ambulanca. Viktimat u identifikuan si Valentin

KUKËS

Dy viktima dhe dy të plagosur është bilanci i një aksidenti të rëndë të shënuar dje në Kukës. Si pasojë e lagështirës, ka dalë nga rruga mjeti tip "Benz", ku ndërruan jetë drejtuesi i mjetit Mustafa Hoda, 45 vjeç dhe pasagjeri Ram Koboçi, 50 vjeç. Një i mitur mori lëndime të lehta, ndërsa 34-vjeçar Xh.H., u transportua në gjendje të rëndë në spitalin e Tiranës.

Zefi 29 vjeç, Edmond Zefi 31 vjeç dhe bashkëshortja e tij, Aida Zefi 21 vjeçe, e cila mësohet se ishte shtatzënë. "Në rrugën Torovicë-Malecaj në Lezhë, një masiv shkëmbor është shkëputur nga mali duke rënë mbi një mjet tip fuoristradë "Land Rover" me targë AA 322 CV. Janë identifikuar 3 viktima, që ndodheshin brenda në mjet pasi

gjysma e mjetit është e shtypur dhe mbuluar nga masivi shkëmbor. Shërbimet policore në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, zjarrfikëset dhe ambulancën ndodhën në vendngjarje për veprime të mëtejshme", tha zyrtarisht policia vetëm pak minuta pas ngjarjes së rëndë. Vëllezërit Zefi ishin nisur nga fshati Rrobosht drejt Torovicës për të marrë pjesë në një festë fetare në familjen e Aidës, kur në vendin e

quajtur kryqëzimi i Rrugës së Kampit u goditën nga masivi shkëmbor, që pasi kaloi mbi automjetin, u ndal disa metra poshtë rrugës. Porca dhe pesha me të cilën shkëmbi ra mbi mjetin fuoristradë e shkatërroi tërë-

sisht atë, ndërsa për nxjerrjen e trupave u desh ndërhyrja e forcave zjarrfikëse. Dyshohet se shkëputja e masivit shkëmbor mund të jetë shkaktuar nga rrëshqitjet e dherave për shkak të reshjeve.

I riu akuzohet se dhunoi gruan, flet vjehrra: Djali im të kthehet në shtëpi tek fëmijët e tij

"S'do e përkrah djalin, nëse lë nusen e jeton me tjetër"

64-vjeçarja: Reli më tha se vajzën e kishte mike, fqinjët më treguan se ishte e dashura

Xhensila Kodra

BERAT

Djalin nuk kam për ta përkrahur asnjëherë, nëse ai përfundimisht vendos se do të largohet nga shtëpia për të jetuar me të dashurën e tij. Unë nusen nuk do ta nxjerr nga shtëpia, por Reli duhet të kthehet për fëmijët dhe të mbajë familjen të bashkuar". Kështu u shpreh dje për "Gazeta Shqiptare", Nabile H., nëna e 31-vjeçarit Reli H., i cili akuzohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëjetueses për ta larguar nga banesa, pasi ka krijuar lidhje me një tjetër femër 64-vjeçarja rrëfen se në momentin që kishte mësuar për historinë e të birit, kishte pasur luhatje të tensionit dhe nuk ishte ndjerë aspak mirë. Pak ditë më parë, "GSH" publikoi një ngjarje të pazakontë të ndodhur në një fshat të Urës Vajgurore, ku Reli H., pasi kishte përcjellë bashkëjetuesen e tij, T. Rama me të cilën ka një djalë 3 vjeç e gjysmë tek prindërit e saj në Dibër, kishte marrë në banesë të dashurën e tij. Me këtë të fundit ishte njohur 4 muaj më parë në Greqi, ku ai punonte si emigrant.

Zonja Nabile, bashkëjetuesja e djalit tuaj ju ka akuzuar për dhunë fizike dhe psikologjike dhe se ju keni dashur ta largoni nga shtëpia, pasi ai do të martohet me dikë tjetër. Si qëndron e vërteta e kësaj historie?

Unë nusen e kam në shtëpi. Nuk e kam dhunuar asnjëherë atë.

Cfarë marrëdhëniesh ke



me të?

Mirë, shumë të mira. Ajo ka mbi 4 vite që jeton këtu dhe ne shkojmë mirë. Si mund ta nxjerr unë atë prej shtëpie?

Djali juaj është larguar nga banesa dhe jeton me vajzën që ka njohur në Greqi. Po me bashkëjetuesen T-në, si i ka pasur marrëdhëniet?

Marrëdhëniet i kanë pasur të mira, edhe pse kishin grindjet e tyre ndonjëherë. Ai në vend që të rrijë në shtëpi me fëmijët dhe nusen e tij, bën këto gjëra që nuk janë fare të mira.

A ju ka treguar Reli për vajzën që kishte njohur në Greqi?

E kam marrë vesh nga komshinjtë e mi. Ata në fillim më thanë se Reli ka gjetur një vajzë tjetër dhe s'më erdhi mirë. Pastaj ai vetë më tregoi se kishte takuar një vajzë në Greqi, por se e kishte shoqe, mikeshë.

Po në momentin që e sollni në shtëpi, si reaguat?

Kur e kishte sjellë në shtëpi unë nuk isha. Ndodheshja jashtë, punoja nga toka. Kur e pashë atë, e pyetja se kush

ishte. Unë jam edhe me tension dhe aty nuk mbaj më se çfarë po ndodhte sepse nuk isha mirë, më ra tensioni. Jo vetëm për djalin dhe nusen tonë nuk është mirë kjo gjë, por edhe për në prindërit e tij që jemi pleq.

Gjatë kësaj jave a keni biseduar me Relin nëse do të kthehet në shtëpi?

Kemi folur disa herë. E kam pyetur se si është. I kam

thënë hajde kthehu në shtëpi, rregulloi muhabetet e tua, por ai nuk na dëgjon ne. Ai duhet të kthehet në shtëpi sa më shpejt për fëmijët e tij dhe të mbajë familjen të bashkuar. Por edhe ai u mërzi kur nusja e denoncoi në polici.

Ju u takuan edhe me Anduelën, vajzën që Reli sollni në shtëpi. Cfarë biseduat me të?

E takova vetëm se në fillim

djali më tha është një shoqja ime, punonte me të. Më vonë nuk kam biseduar asgjë me të.

Reli ka në shtëpi edhe një vajzë nga martesë që ai kishte më parë. Si e ka përjetuar ajo ikjen e të atit?

Nusja që kam në shtëpi e ka mbajtur vajzën në pëllëmbë të dorës dhe ajo nuk do t'ia dijë fare nëse rri apo i ikën i atij, sepse ai asnjëherë nuk është sjellë mirë me të. Ne e kemi rritur.

Mendonit se sjellja e tij është diçka kalimtare dhe a do të kthehet ai në shtëpi?

Ne jemi familje e rregullt dhe këtë gjë djali im nuk duhet ta bënte. Ai do kthehet në shtëpi, sepse nuk ka se ku të shkojë.

Nëse ai ka marrë vendimin se nuk do të kthehet më në shtëpi, do e përkrahni?

Jo, nuk kam për ta përkrahur asnjëherë. Edhe nëse ai më kërkon që ta nxjerr nusen nga shtëpia, nuk ka bërë ta bërë këtë. Asaj i kam thënë që e kam si vajzë time. Edhe pse në fillim u mërzi shumë që e denoncoi. I thashë pse e bëre, sepse mund ta kishim rregulluar edhe brenda për brenda familjes. Ajo sa e mori vesh kush ishte, i kërkoi që ti zhdukeshin nga sytë dhe ata ikën, u larguan.

Po me gruan e parë me të cilën Reli ka dy fëmijë, pse u divorcua?

Sepse ajo gaboi në jetë dhe e tradhatoi. Nga kjo gjë edhe djali im ndryshoi e u bë kësh-tu. Ajo na e tregoi vetë se me kë persona e kishte tradhatur djalin dhe më pas u ndamë.

Po me familjen e Anduelës, a jeni takuar dhe biseduar me ta?

Jo, fare. As nuk i njoh dhe as nuk kemi biseduar me ta.

VLORE

Nuk kallëzoi vjedhjen e një gomoneje, arrestohet roja e lokalit në Orikum

Policia e Vlorës ka nënë në pranga rojën e një lokalit, pasi akuzohet për vjedhje dhe moskallëzim krimi, sepse nuk denoncoi vjedhjen e një mjeti lundrues gomone në Orikum. Burime zyrtare të policisë bënë me dije se i arrestuari është shtetasi Skënder Kongjoni, 57 vjeç, banues në Orikum. Ky i fundit akuzohet për moskallëzim të krimit, pasi dyshohet se ka qenë i pranishëm dhe ka parë personat që kanë vjedhur mjetin lundrues tip gomone në pronësi të shtetasit A.K., me vendbazë të deklaruar pranë lokal "Orikum", Orikum. "Vjedhja e mjetit lundrues është kryer më datë 06.10.2017 rreth orës 03:00, nga tre shtetas ende të paidentifikuar në vendbazë e saj pranë lokal "Orikum", ku Skënder Kongjoni shërbente si roje. Ky shtetas në asnjë moment nuk e ka kallëzuar kryerjen e këtij krimi në organet e ndjekjes penale, ose në organet e rendit publik", tha zyrtarisht policia.

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., ofron shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Apartamenti" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 11, Faqe 32, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 28,123 Euro;

- "Ndërtesë" me sipërfaqe 15.5 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Luljeta dhe Sabiola Beqiraj, me Nr. Pasurie 5/61. Çmimi fillestar i ankandit është 22,680 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.10.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Ngjarja në Elbasan, mbetet në burg 31-vjeçari e kunati i tij. I riu: Drogën e kisha për përdorim vetjak

Enea Bekteshi: S'doja të qëlloja mbi policinë, iu shmanga pasi ata qëlluan me 4 plumba drejt meje

"Sot mund të isha i vrarë nëse 'Audi' nuk do ishte i blinduar"

Xhensila Kodra

Enea Bekteshi mori përsipër se ishte ai drejtuesi i "Audi" të blinduar, që përplasi mjetin e zv/drejtorit të Policisë mbrëmjen e 18 shtatorit në derën e tregut agro-ushqimor në Elbasan. Gjatë dëshmisë që 31-vjeçari dha në Gjykatën e Krimeve të Rënda, mohoi të kishte qëllim goditjen e punonjësve të policisë dhe akuzoi këta të fundit për tentativë vrasjeje. I riu theksoi më tej se nuk i njohu se ishin punonjës policie dhe se u largua nga frika, pasi mjetin ia kishte marrë pa leje pronarit të tij, biznesmenit Petrit Çelës dhe se ndodhje nën efektin e alkoolit dhe të lëndës narkotike. Ndaj tij prokurori i çështjes kërkoi masën e arrestit me burg, pasi me goditjen e mjetit të policisë, ai ka kryer veprën penale të vrasjes së punonjësve të policisë, të mbetur në tentativë. Por kjo kërkesë u kundërshtua nga avokati mbrojtës i Bekteshit, i cili kërkoi një masë lehtësuese, atë të arrestit shtëpiak me mbikëqyrje elektronike. Së bashku me 31-vjeçarin, në kafazin e hekurt u ul edhe kunati (burri i motrës) së tij, i cili akuzohet për përkrahje të autorit të kimit dhe mbajtjes së armëve të ftohta, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesë iu gjet e fshehur një bajonetë. Pasi dëgjoi palët, gjykata e cilësoi si të ligjshëm arrestimin e dy të dyshuarve, si dhe caktoi masën e sigurisë "arrest me burg" për Enea Bekteshin dhe kunatin e tij, Aleks Pupuleku.



Enea Bekteshi



Aleks Pupuleku

shkova në shtëpinë e motrës, por jo për të futur kunatin në burg. Hashashi që u gjet është i imi, e kam për përdorim vetjak. Kam 12 vite që konsumoj drogë", pohoi ai. Edhe avokati Genci Gjokutaj arsyetoi para gjykatës se i mbrojturi prej

tij nuk mund të akuzohet për vrasje të punonjësve të policisë të mbetur në tentativë, pasi ata ishin pa uniformë, pa shenja dalluese dhe më e rënda sipas tij, pa asnjë paralamjërëm është qëlluar 4 herë në drejtim të "Audi". Gjokutaj tha se përplasja

ishite aksidentale, pasi makina që u godit po ecte mbrapsht, ndërsa Bekteshi po përpiqej t'i shmangej policisë nga frika se mos arreshtohet për drejtim të makinës në gjendje të dehur, duke qenë se e kishte marrë edhe pa lejen e pronarit të tij. Por, ndry-

she nga sa deklaroi i dyshuari, prokuroria ende e ka të paqartë se kush ishte personi që drejtonte "Audi"-n e blinduar, por theksoi faktin se shenjat e gishtërinjve të dorës së majtë të Enea Bekteshit gjenden në derën e makinës në anë të pasagjer-

it. Prokurori i çështjes sqaroi në gjykatë se i dyshuari Bekteshi, Suel Çela dhe personat e arrestuar më herët kanë udhëtuar nga Elbasani drejt Rinasit, duke përcjellë për jashtë vendit njërin prej djemve të biznesmenit Petrit Çela. Nga kamerat e sigurisë vërehet se në aeroport shfaqen dy makina, "Audi" i blinduar dhe një makinë "Range Rover". Të njëjtat makina duken edhe në pamjet filmike të kamerave të sigurisë në tunelin e Kërrabës gjatë kthimit. Por, ndryshe nga sa policia deklaroi në krye të herës se aksioni kishte qëllim bllokimin e makinave luksoze apo atë të trafikuarat, prokuroria tha se ky aksion nisi pas një telefonate të bërë në polici nga shtetasi Sokol T., i cili pretendonte se disa persona që udhëtonin me një "Range Rover" dhe "Audi" i kishin drejtuar armën duke tentuar për ta vrarë. Pas kësaj telefonate, policia ndaloi për verifikime "Range Rover"-in dhe pak minuta më vonë "Audi" i blinduar shkaktoi incidentin me policinë.

Psatha shpërndante kokainë në lokalet e natës

Shfrytëzonte femra për prostitucion kundrejt 50 eurove, kapet 38-vjeçari


DURRËS - Blutë e qytetit bregdetar kanë vënë në pranga një 38-vjeçar nga Durrësi, i cili akuzohet se shfrytëzonte femra për prostitucion kundrejt një pagese prej 50 eurosh, si dhe shpërndante kokainë në lokalet e natës në këtë qytet. Ditën e djeshme, specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimit të Organizuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, pas një hetimi 6-mujor me metoda speciale finalizuan me sukses operacionin e koduar "Postieri", ku u bë i mundur arrestimi në flagrancë i shtetasit Hektor Psatha. "Gjatë veprimeve hetimore të kryera nga ana e specialistëve të Sektorit për Hetimin e Krimit të Organizuar është dokumentuar se shtetasi i mësipërm shfrytëzonte femra për prostitucion



Momenti i arrestimit

kundrejt pagesës prej 50 euro dhe shpërndante lëndë narkotike në lokalet e natës, kryesisht në zonën e plazhit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Sakaq, pas arrestimit të tij gjatë kontrollit, policia ka sekuestruar në cilësinë e provave materiale 22 doza lëndë narkotike e dyshuar e llojit kokainë, një automjet tip "Toyota Yaris",

2 telefona celularë. Mësohet se Psatha është person me precedentë penalë të mëparshëm në fushën e veprave penale kundër pronës. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Shfrytëzim prostitucioni" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".



Iu gjet kanabis në banesë, policia arreston babë e bir në Lushnjë

LUSHNJË - Një 50-vjeçar është arrestuar nga policia së bashku me të birin, pasi në banesën e tyre u gjetën disa bimë kanabisi. Në pranga janë vënë Tasim Balla si dhe 24-vjeçari, Saimir Balla. Mësohet se në oborrin e banesës së tyre në fshatin Ballagat u gjetën 32 bimë kanabis dhe gjatë kontrollit të mëtejshëm u zbulua edhe një sasi prej 5 kg kanabisi në proces tharjeje. Sipas policisë, ata akuzohen për veprat penale "Prodhim dhe shitje të narkotikëve" dhe "Kultivim të bimëve narkotike". Arrestimi i 24-vjeçarit u bë ditën e djeshme nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisarriatin e Policisë Lushnjë, ndërsa shtetasi Tasim Balla u arrestua dy ditë më parë.

Në fshatin Ballagat u gjetën 32 bimë kanabis dhe gjatë kontrollit të mëtejshëm u zbulua edhe një sasi prej 5 kg kanabisi në proces tharjeje.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikat e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së pestë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikat që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistrin janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën trull, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E PESTË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Rexhep	Zeqa	Cake	Mehaj	5530m2 truall	Puke / 3069	84	5530	230	Ka Vert.Kadastrale Ka harte
Prende	Lufi	Prend	Lufi	11700m2 truall	Luf / 2505	87	11700	9949	Ka VFJ Ka Harte
Nikolle	Gjoni	Nikolle	Gjoni	3006m2 truall	Kcire Puke / 2130	88	3006	2446	Ka VFJ Ka Harte
Mus	Islami	Hamit	Mehaj	8810m2 truall	Puke / 3069	89	550	550	Ka dokm.hip otekor Ka harte
Prend	Ndoka	Zef	Ndoka	3000m2 truall	Bicaj / 1179	90	3000	3000	Ka dokm.hip otekor Ka harte
Leke	Preka	Gjeke	Preka	120.7 dyt.truall	Pulaj / 3072	500	21000	8300	Ka VFJ Ka Harte
Sulejman	Hoti	Nazmije	Bushati(Hoti)	5000m2 truall	Samr ishte / 3258	499	2000		Ka vert.pronesie Ka Harte
Sal	Cela	Sal	Ademi	25000m2 truall	Mjede / 2702	478	9500	5500	Ka vert.pronesie Ka Harte
Nurije	Cepelia	Halim	Harapi	1000m2 truall	Bushat / 1329	308	1000	1000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Nik	Marashi	File	Marashi	80000m2 truall	Bushat / 1329	307	5300	5300	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua
Halil	Hoti	Violeta	Hoti	10200m2 truall	Dobrac / 1495	306	10200	10200	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua
Ali	Zeneli (Deltina)	Latif	Deltina	18000m2 truall	Dobrac / 1495	305	10800	10800	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua
Malo	Duli	Muhamet	Duli	8570m2 truall	Rrethina / 1495	497	7336	1736	Ka VFJ Ka Harte
Gjeto	Luca	Nikolle	Zefi	10400m2 truall	Rec I Ri / 3159	496	10400	7500	Ka VFJ Ka Harte
Ndue	Marku(Shkembij)	Kol	Shkembij	700m2 truall	Shllak	495	700	700	Ka VFJ Ka Harte
Ndoc	Oca	Luigj	Molla	1000m2 truall	Velipoje Rrjoll Baks / 1076	494	1000		Ka vert.pronesie Ka Harte
Mrika ; Nikolla	Toma	Preng	Shkoza	10000m2 truall	Lac Vau Dejes / 8598	493	9900		Ka VFJ Ka Harte
Prel	Selita	Pashko	Selita	41650m2 truall	Velipoje / 3734	492	7977	2977	Ka VFJ Ka Harte
Kisha Hajmel		Kisha Hajmel		27450m2 truall	Hajmel / 1920	491	27450		Ka vert.kadastral Ka harte
Kisha Lac		Kisha Lac		21400m2 truall	Narac / 2763	490	23400		Ka vert.kadastral Ka harte
Provinca Franceskane Shqipetare		Provinca Franceskane Shqipetare		10000m2 truall	Pog / 3011	309	10000		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ismet	Bushati	Ismet	Bushati	1000m2 truall	Bushat / 1329	304	1000	1000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Rrok	Nushi	Rrok	Pjetrushij	10000m2 truall	Rranxa Bushat / 3205	303	10000		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Dede	Gjergji	Mhill	Gjergji	10000m2 truall	Rranxa / 3205	302	8750		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kole	Leka	Ndoc	Leka	200m2 truall	Gushte Shllak	301	200	200	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Hysen	Barbullushi	Rasim	Barbullushi	500m2 truall	Barbullush / 1100	300	500	500	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua

Tetë militantë ndalohen në Sabah, po planifikonin sulme terroriste

Arrestohet për lidhje me ISIS pedagogu shqiptar në Malajzi

Mediat e huaja: Është një 35-vjeçar

Një shqiptar 35-vjeçar për të cilin mediat e huaja shkruajnë se është pedagog në një universitet publik në Shqipëri është arrestuar në Malajzi, pasi akuzohet se ka lidhje me grupin terrorist ISIS në Siri dhe në Irak. Ai u vë në pranë në kuadër të një aksioni të gjerë të ndërmarrë në Malajzi, ku arrestuan 8 persona gjithsej. Emri i tij nuk bëhet i ditur. Tetë militantë të dyshuar, pesë nga të cilët që kanë lidhje me grupin Abu Sayyaf (ASG), baza e të cilit është në jugperëndim të Filipineve, u ndaluan pas një aksioni të madh në tri shtete", - tha një inspektor i policisë vendëse në Malajzi, në Azinë Juglindore. Inspektori i Përgjithshëm i Policisë tha se të dyshuarit u kapën në tri rajone Sabah, Selangor dhe Perak midis 27 shtatorit dhe deri në 6 tetor gjatë aksioneve që policia vendëse kishte ndërmarrë. Në serinë e parë të arrestimeve, në Sandakan dhe Sabah, më 27 shtator u arrestuan dy persona malajzianë, dy filipinas dhe një tjetër filipinas me status rezidenti të përhershëm në Malajzi. Dy të tjerë të arrestuar janë ish-të dënuar, të shpallur më parë fajtorë në vitin 2016 për pjesëmarrje në aktivitetet terroriste. Njëri u arrestua nën dyshimin për rekrutimin e të dënuarve me burg dhe planifikimin e një sulmi ndaj vendeve myslimane, të krishtera dhe hinduse të adhurimit në Malajzi. I dyshuari thuhet gjithashtu se ka informacion rreth një anëtarë të Tanzim Al-Qaeda Malaysia, një grup i lidhur me Jemaah Islamiyah, i cili mbetet i lirë. Tjetri ishte një bashkëpunëtor i dyshuar për rekrutimin e dy malajzianëve. Malajzia ka arrestuar qindra njerëz gjatë viteve të fundit për lidhje të dyshuara me grupet terroriste. "Ne besojmë se ata po bënin udhëtime për militantët e ASG në Malajzi", tha oficeri. Inspektori i policisë tha se një 35-vjeçar



Momenti i arrestimit të 35-vjeçarit shqiptar

shqiptar, i cili është lektor në një universitet publik në Shqipëri, është arrestuar gjithashtu në Selangor më 1 tetor. "Inteligjenca tregoi se ai ka lidhje me militantët e Shtetit Islamik (IS) jashtë shtetit", tha ai, duke iu referuar grupit islamik në Irak dhe Siri (ISIS). "Qëllimi i tij ishte të nxiste konflikte racore dhe fetare në shtete", tha inspektori. Autoritetet vendëse kanë qenë në alarm që pas sulmit në kryeqytetin Kuala Lumpur, qershorin e këtij viti, ku tetë persona u plagosën nga militantët e ISIS. Një sulm me granata në një bar në periferi të kryeqytetit malajzian, Kuala Lumpur, në qershor plagosi tetë vetë. Shteti Islamik mori përgjegjësinë për sul-

met, që ishin të parat të kësaj natyre në tokën malajziane. Në ditën në vijim autoritetet shqiptare do të bëjnë me dije edhe emrin e pedagogu shqiptar, që është arrestuar për lidhjet e tij me Shtetin Islamik të ISIS.

POLICIA

Inspektori i policisë tha se një 35-vjeçar shqiptar, i cili është lektor në një universitet publik në Shqipëri, është arrestuar gjithashtu në Selangor më 1 tetor. "Inteligjenca tregoi se ai ka lidhje me militantët e Shtetit Islamik (IS) jashtë shtetit", tha ai, duke iu referuar grupit Islamik në Irak dhe Siri (ISIS).

SPANJË

Tubime në Katalunjë, populli s'pranon referendumin

Në shtetin spanjoll priten të zhvillohen tubime masive kundër pavarësisë së Katalunjës, pas referendimit të së dielës. Demonstratat janë planifikuar të mbahen në Madrid si dhe në qytete të tjera. Pjesëmarrësit në protesta do të jenë përkrahësit kundër referendimit të Katalunjës, që do të bëjnë thirrje për marshime të ngjashme edhe në Katalunjë të Barcelonës. Qeveria spanjolle më herët ka kërkuar falje për dhunën që kanë shkaktuar forcat policore për të ndaluar referendumin dhe kanë fajësuar qeverinë e Katalunjes për organizimin e një votimi antikushitetues. Qindra njerëz u plagosën gjatë përleshjeve, kur policia spanjolle u përpoq të merrte kutitë e votimit të referendimit katalunjas dhe të shpërndante votuesit. Gjithashtu, 33 efektive mbetën të plagosur. Ka spekulime se parlamentit do ta shpallë pavarësinë në mënyrë të njëanshme në seancën e ardhshme, bazuar në referendumin. Gjykata Kushtetuese e Spanjës ka pezulluar më herët seancën e parlamentit katalanas, që ishte planifikuar për të hënë.

Ngjarja në lagjen e 40-vjeçarit, në Asti të Italisë

Plagoset shqiptari me dy plumba, policia: Dyshojmë se është qëlluar nga bashkatdhetarët



mësohet se është jashtë rrezikut për jetën. Ende nuk ka të dhëna për autorët e ngjarjes, ndërsa policia bën me dije se ka dyshime se ai mund të jetë qëlluar nga të tjerë shqiptarë. Policia italiane është duke hetuar në lidhje me ngjarjen, nëse ka lidhje me pazare të drogës, apo ka ndodhur për motive të dobëta.

Një shqiptar është plagosur me armë zjarri në orët e parë të ditës së djeshme në Itali. Siç bëhet e ditur nga mediat italiane, shqiptari i moshës 40 vjeç është qëlluar me dy plumba, duke mbetur i plagosur. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në komunën Asti, teksa shqiptari ka dalë në banesë e tij në "Quarto d'Asti". Në këtë moment, dy persona të paidentifikuar i janë afruar dhe kanë qëlluar në drejtim të tij. Shqiptari, emri i të cilit nuk bëhet i ditur është dërguar në spitalin "Cardinal Massaia" nga disa të afërm dhe

NJOFTIM PER SHITJE

Ne Zyren e Permbaruesit Gjyqësor Arjan Palla me adrese Blv. Zogu i I-re, Pall. Agimi, H-2. K-3, Ap.-5-Tirane me dt. 10.10.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise me nr. 1/197 +3-26, vol.8, fq.48, z.k 8260, lloji I pasurise apartament me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane, rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa. Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 40579,2 Euro.

Njoftim

Permbaruesi gjyqësore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine : "Apartment" me sip totale prej 73 m2 e regjistruar ne regjistrin hipotekore , vol 1 , faqe 195, me nr pasurie 2/4134-1-17, ne ZK 8592 me adrese Qytet. Shkoder".
Cmimi fillësarë për shitjen në ankand është në masën **2,520,000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë**.
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 16.10.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqësore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykatës se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Njoftim

Permbaruesi gjyqësore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine : "Apartment" me sip 127.7 m2, e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr 82 date 02.06.2011 me volumi 5 faqe 108 me nr pasurie 16/130+1-8, ne Zonen Kadastrale 8597 me adrese, lagja "Pazare", Shkoder.
Cmimi fillësarë për shitjen në ankand është në masën **3,472,000 (tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë**.
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 13.10.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqësore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykatës se rrethit Gjyqësore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

REPUBLIKA E SHQIPËRIË DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORES LITUM" (EXC LIT) sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasuritë e paluajtshme :
1- Pasuria "Trulli" me sip. 2950 m2 + ndërtesë me sip. 2275 m2, e regjistruar ne ZVRPP Tirane ne ZK 2679, me nr. pasurie 5024, vol.35, faqe 58 dhe pasuria "Trulli" me sip. 1050 m2 + ndërtesë me sip. 507 m2, e regjistruar ne ZVRPP Tirane ne ZK 2679, me nr. pasurie 5023, vol.35, faqe 57 e ndodhur ne Mezozi, Tirane, ne pronesi te "DISTRIBRANDOS" shpk. Cmimi me te cilin do te filluaj ankandi eshte ne vleren 1,026,648 Euro.
2- Pasuria "Ari" me sip. 1,400 m2, e regjistruar ne ZVRPP Tirane ne ZK 2679, me nr. pasurie 4716, vol.4, faqe 80, ne pronesi te "DISTRIBRANDOS" shpk. Cmimi me te cilin do te filluaj ankandi eshte ne vleren 56,448 Euro. Ankandi do te zhvillohet ne date 12.10.2017 ora 16.00, ne zyren e permbarimit "Executores Litum" sh.p.k, me adrese Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tirane

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORË "KREON" ME PËRMBARUES GJYQËSORË SUELA METHOXHA

Dt 12.10.2017 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Dytë për pasuritë:
- **Apartment me sip. totale 72 m2, me adres në Rr. "1 Maji" Korçë, Me çmim 18 144 Euro**
- **Apartment me sip. totale 86.03 m2, me adresë në Pogradec Me çmim 3 060 000 Lekë**
Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORË "KREON", me adr: L.11, Blyv.kryesor (ish kinma iliria), Kati-2, Durrës, Kontakti Kc 0682096575

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 11.10.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqësor privat **Irisa Terezium PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdeh, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Njese" me siperfaqe totale 87.2 m², numer pasurie 15/231-N1, vol.2014-2016, ne zonen kadastrale 8551, me adrese Kavaje. Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 8,329,553.6 (tete milion e treqind e njetzet e nente mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre pike gjashtë) lekë.

PERSONAZH

Fatmira Nikolli

“Arrëthyesi i artë” Ervis Nallbani: Skena është e shenjtë

17 vite në skenën e TKOB, balerini: Ballafaqimi me gjendjen psikologjike e shpirtërore të rolit

Oficieri i “Lumit të Vdekur”, princi te “Bukuroshja e fjetur”, mësuesi te Hi rushja, Sokoli te “Halili & Hajria”, vëllai te “Gjergj Elez Alia”, Skllavit dhe Idoli te “Bayadera”, Hani te “Sheherezade”, I Riu te “Migjeniana”, Djalli te “Delina”, Jose te “Carmen”.

Balerini i parë i TKOB-së Ervis Nallbani, ka mishëruar dhjetra role në baletet më në zë të skenës shqiptare, por përvoja e tij dhe interpretimi i kalon kufijtë. Njëherit pjesë e disa spektakleve televizive, 36-vjeçari, prej 17 vitesh është pjesë e pandarë e magjisë së Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit ku ka marrë disa prej roleve kryesore.

Falë bashkëpunimit me kompaninë “Theatre International” Nallbani u bë pjesë e shfaqjeve në: “10 komandamentet”, “Katedralja e Parisit”, “Romeo & Juliet”, “Moulin Rouge”. Një vit më vonë, në 2012-n, ai interpreton rolin e parë në baletin “Mandarinin i Mrekullueshëm” me koreografi te David-Miklos Kerényi si dhe vepra të tjera në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë. Në nëntor të vitit 2013, Ervisi largohet drejt Italisë ku punon me Kompaninë “Balletto del Sud” kompani e drejtuar nga Fredy Franzutti. Po në këtë vit ai realizon një shfaqje me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Agron Aliajt, “Agroniada”, interpreton “Plaga e 10-të e Gjergj Elez Alisë”, “Pas de deux - “Arrëthyes”, etj. Me trupen e baletit në Nepi, Itali- fitoi çmimin “Arrëthyesi i Artë”, duke vijuar me baletin “Historia e një kënge” në rolin e profesorit me koreografi të Enada Hoxhas dhe në baletin “La Traviata” duke pasur rolin kryesor si Alfredo. Talenti, puna dhe serioziteti i Ervis Nallbanit do ta shpërblenin atë dhe në vitet që pasuan. Në vitin 2014 ai merr pjesë në baletin “Balloja e Diplomës” në rolin e Kadetit të I vazhdoi në baletin “Risveglio dell’umanità” me koreografi të Mariuel Stefanescu. As muzikalet nuk kanë qenë jashtë shfaqjeve ku ai ka pasur rolin e tij. Ndërkaq, koreografi i mirënjohur, Tony Candeloro, koreografi atë në rolin e Krishtit në baletin “Caravaggio”. Në po të njëjtin vit, baleti “Zhizel” rikthehet në skenën e TKOB-së dhe performon në rolin kryesor “Albert” me koreografi te Marius Petipa dhe rivene nga mjeshtri Agron Aliaj, vijoi me baletin “Romeo & Zhuljeta” me koreografi nga Pe-

ter Lukanov ku interpreton Romeo, role që i sollën dhe nominimin për Çmimet Kult si “Balerini i Vitit”. Së fundmi u shfaq tek “Peshkatarët e perlave”.

-Jeni balerin që keni interpretuar në disa tituj në TKOB. Si ka qenë ky rrugëtim?


I bukur dhe kur përkufizoj të bukurën hedh brenda mundin, sakrificën, përpjekjen jo vetëm timen por edhe të atyre që më kanë mbështetur në këtë rrugëtim ku vendin e parë padyshim e ka familja ime.

-Nga vepra si “Lumi i vdekur” a “Gjergj Elez Alia” te “Carmen”, “Liqeni i Mjellvame”, “Arrëthyesi”. Cili është procesi i punës që vetë balerini bën me rolin?

Studimi i veprës dhe studimi i karakterit. Ballafaqimi me gjendjen psikologjike e shpirtërore, analizimi i kësaj të fundit (timen) dhe ndërthurja me karakterin e vetë veprës. Koreografia, arritja teknike dhe artistike janë pjesë e domosdoshme e këtij procesi.

-Ku ndryshojnë koreografët shqiptarë si Agron Aliaj, me ata të huajt si Tony Candeloro?

Nënshtrëtesia.
-Duket se paqja viteve të shumta në opera, famën e jep televizioni, edhe pse zhanret janë të ndryshme dhe për balerinin, karriera bëhet në teatro më shumë se sa në spektakle. Si është kjo marrëdhënie mes famës dhe karrierës, mes veprës së mirë-



Balerini, Ervis Nallbani

filltë dhe numrave në spektakle?

Është fenomen i njohur kudo dhe jashtë vendit. Në Shqipëri ndoshta ky diferencim është pak më i theksuar për shkak të tranzicioneve të njohura në historinë e kombit tonë. Arti mendoj se e ka përjetuar/vuajtur pak më tepër se fushat e tjera. Pavarësisht se jemi në 2017 dhe kushdo nga ne e njeh shumë mirë rëndësinë e mediave televizive. Tani ne jemi në dijeni të ndarjes që ekziston te publiku dhe si pasojë që në momentin e parë kur mer përshpër të performosh në të dyja skenat duhet të vendosesh në funksion aftësitë e tua në përshtatje. Nuk

dua të flas për shkallë rëndësie sepse për mua skena e shkëlur është e shenjtë.

-Ka kaluar në heshtje përjetori i Agron Aliajt. Si do ta mbani mend? Pse i mungon operës një emër si ai?

Si mjeshtrin e koreografisë shqiptare dhe një artist të shquar me kontribute të mëdha. Pak më shumë vëmendje karshi të kaluarës s’do na bënte aspak keq. Prof. Agroni do na mungojë jo vetem neve që patëm fatin ta njihnim dhe të punonim, por dhe brezave në vazhdim.

-Jeni shpallur balerini i vitit në një event të përvitshëm. Si ka qenë angazhimi tuaj atë vit deri te çmimi?

I njëjti angazhim i çdo viti që nga mosha 10-vjeçare.

-Veç roleve në baletet klasike nuk kanë munguar rolet e mëdha edhe në baletet kontemporane. Ku ndjeheni vetvetja më shumë? Apo varet nga roli?

Është çështje e karakterit të rolit dhe mënyrës së përpunimit të brendësisë sime në periudhë të caktuar. Zhanri nuk përbën rëndësi themelore.

-Çfarë keni marrë nga puna në baletin e Preljoçajt, një nga emrat më të lakuar sot?

Mos të përmedim aftësitë e medha në stilin bashkëkohor, do të thoj bashkangjitja e çdo note muzikore në një lëvizje të specifikuar baletit.

-Keni qenë i angazhuar edhe jashtë vendit. Pse është Ervisi ende në Shqipëri, ku mundësitë që jepen nuk duken shumë, ose gjithësesi ka shumë vështirësi të jetosh si artist?

Dashamirësia e madhe për t’i dhuruar nga vetja ime artit të baletit shqiptar. Pavarësisht vështirësive dhe mundësive të pakta që ofron vendi në këtë fushë gjithmonë jam munduar ta ushqej veten me frymën e pozitivitetit që më mbante gjallë, gjë që ma ofronte publiku sa herë prekja skenën.

“Arti i procesit”, dialog brenda e jashtë mureve

Fatmira Nikolli

Statujat monumentale ndër futen si shenja në hapësirë, kësajsoj përcaktojnë kohën dhe përcaktohen në kohë. Hija monumentale ka fuqinë të lërë në hije ata që i afrohen. Vetëm turma nuk ka frikë nga përplasjet. Mund ta përmbysë pushtetin. Kur ajo mbledhet në masë, përcakton shenjë që ripërcakton një qendër të re, kështu që hijet e statujave dhe ato të njerëzve shkrihen: marrin pjesë në një qenie të re monumentale-Baubas, Arti i Procesit, Center For Opennes and Dialogue, Tiranë.

Në përmblyllje të sezonit “Proceset dhe Rezultatet” me finalizimin e projektit Arti i Procesit, kam në krah Valentina Bonizzin, që më shpjegon një pas një çdo objekt e letër në ekspozitë-laborator të konceptuar prej saj për hapësirat e Qendrës, që synoi të bënte bashkë dialogun mes sipërmarrjeve sociale në vend, me artin relational.

Ka qenë një rrugëtim disamujor, ky i Artit të Procesit. Krejt rastesisht, kam qenë e përditësuar njëfarësoj me hapat e saj, për sh-

kak të profesionist dhe takimeve të herëpashërme në ekspozita e festivale. Bonizzin më ka folur gjithnjë me shumë pasion për këtë projekt. Në ditën kur ekspozita çel, ka hequr barrën e të qenit në proces dhe tanimë nuk shih para, por shih pas, për të rrefëruar një udhëtim që është në fund, e jo një udhë në mes.

Në një kuptim krejt të ngushtë, mësimi i parë i artit të procesit, është me gjasë, leksioni se duhet shijuar çdo hap i udhës, pa mësyre veçse fundin, fundi le të jetë destinacioni, por rëndësi ka po aq udha e përshkuar. “Me BAUBAUS lindi një bisedë në largësi dhe në përfundim të procesit do ta quaja thuajse qendër e shkëputur nga BAUBAUS në Tiranë. Me këtë, për mua fillon një lidhje e dyfishtë për Artin e Procesit: dialogët rreth Ligjit 65 me sipërmarrësit sociale gjatë orëve të pikut të protestës, lidhje që më pas u dyfishua, me dy metoda e gjeografi të ndryshme, dhe kjo, në bashkëpunim me artistët që kisha ftuar gjatë ekspozitës-laborator. Meqë s’kam marrë pjesë ndonjëherë te BAUBAUS në Itali, u përpoqa të kapja thelbin nëpërmjet



sugjerimeve të Patrizios”, shkëputim nga Bonizzin, kërkuese e asociolog, në Qendrën për Hapje dhe Dialog, një hapësirë dedikuar artit, hulumtimit dhe politikës, në Kryeministri, në Tiranë.

Për takimin e parë, fjala vjen, u reflektua mbi vizatimin e një gjeografie të re, që të vendoste dhe t’i vendoste në lidhje me kundërshtinë e krijuar mes institucionit ndaj të cilit protesta bëhej dhe vendit publik në të cilin manifesto-heshin të dyja. Për Bonizzin, manifestimi i protestës përpara Kryeministritë krijonte kufij të rinj brenda të cilëve humbiste perceptimi i sigurisë, një zonë manifestimi publik, që i merrej publikut.


Projekti ka zhvilluar paralelisht dialogun mes ndërmarrjeve

sociale në vend, po ashtu praktika pjesëmarrëse të artistëve bashkëkohorë në prodhimin e kuptimeve të reja, që zhvendosen nga qendra e kryesisht kanë të bëjnë me procesin dhe cilësinë e tij. Duke rikonsideruar kuptimin e hapjes dhe dialogut me përdorimin e artit bashkëkohor, proceseve ligjëbërëse dhe hulumtimit, projekti nxit reflektim. Për muaj me radhë, në COD dhe jashtë tij janë zhvilluar një seri dialogësh mes sipërmarrësve socialë në Shqipëri dhe prezantimesh. Arti i Procesit regjistroi dhe bëri transparente në faqen web diskutimet mbi Ligjin 65 “Mbi Ndërmarrjet Sociale”, ende në proces shkrimi të akteve nënligjore, duke synuar dialog të qëndrueshëm mes sipërmarrësve socialë dhe ligjëvënësve.

Të pranishëm në ceremoninë përmblylëse të projektit, veç përfaqësuesve të ndërmarrjeve sociale, ishin edhe artistët që bashkëpunuan me Artin e Procesit: Patrizio Raso i Baubas dhe Giusti Campisi e Muzeut Wunderkammer. Biseda e tyre, solli në vëmendje përvojat bazuar mbi eksperimentin. Në ekspozitë-laborator që

qëndron e hapur deri më 14 tetor, veç punimeve të realizuara në hapësirat eksperimentale nga bashkëpunimet e Valentina Bonizzin-t dhe një grupi aktivistësh shqiptarë me Wurmkos, Baubas dhe Wunderkammer, paraqiten edhe punë të Fondacionit Lac o Le Mon, Il Fondo Speculativo di Provvidenza (FSP) dhe Stalker, si ndërhyrje të artistëve bashkëkohorë që punojnë me praktika pjesëmarrëse e të bazuara në komunitet e në kontekstin tonë, përmes artit ofrojnë një model apo një hapësirë reflektimi për zhvillimin e mikroekonomive të qëndrueshme sociale. Wurmkos është një laborator të arteve pamore, krijuar në vitin 1987 nga Pasquale Campanella në Sesto San Giovanni dhe lidh artin me shqetësimet psikike, pa përcaktuar objektiva shpëtim. Baubas u themelua në vitin 2010 në Milano nga Patrizio Raso, si një veprimtari kërkimorë e cila përdor artin për të punuar në zbulimin eksperimental të vetvetes, nëpërmjet vëzhgimit kolektiv dhe refleksionit. Muzeu Wunderkammer i Trentos e përcakton veten si një veprimtari, si gjest politik, si aftësi akrobatike. Mbledh dhe katalogon vende, brenda hapësirës urbane, nga njerëzit që jetojnë dhe lëvizin në qytet.

E DIEL
8 Tetor
2017



e-mail: milosa02005@yahoo.com



Ekskluzive

Michele Greco da Valona: "Madona con Bambino tra san Giovanni e sant' Adamo"

Mihal Ortodoksi nga Vlora NJE PIKTOR NGA VLORA NE RILINDJEN ITALIANE

Ekspozitë për një piktor shqiptar të viteve 1500

Në këtë numër: In memoriam Robert Elsie, Dasha Drndiç, Irakli Koçollari, Shpëtim Çuçka për Dritëro Agollin, Bardhyl Agasi, Merita Shkupi, Behrim Jusufi etj...

NGA PROF. IRAKLI KOÇOLLARI

Më 28 Qershor 2011 në Kastelo Piko lomini të Çelanos u hap një ekspozitë me temë: "Rilindja valluese - Michele Greco da Valona (Mihal Ortodoksi nga Vlora) dhe piktorët e Adriatikut mes Abrucos dhe Molises".

Sigurisht, kjo ishte një ngjarje e veçantë dhe mjaft domethënëse që bëri të njohura punët e mrekullueshme të një mjeshtëri shqiptar të penelit, të panjohur gjer më tani. Prezantimi i artistit shqiptar, Michele Greco da Valona ishte një iniciativë e Këshillit të Trashëgimisë të Vlerave Artistike dhe të Etnoantropologjisë për zonat e Abrucos dhe Molises.

Këshilli Bashkiak i Molises u sugjeroi me atë rast studuesve të fushës së artit figurativ pjesëmarrjen në një Konferencë me karakter kërkimor, si dhe në një vizitë në kishën e mrekullueshme të Santa Maria Maxhore të Kampobasos, ku gjendet një pikturë e fillimit të shekullit të XV, e piktorit shqiptar, "Mihal Ortodoksi nga Vlora".

Në fillimet e shekullit të XV, Mikele da Valona, që kish-te mbërritur në brigjet latine nga Shqipëria, shkoi dhe u vendos në Abruco dhe prej këtu qarkulloi në terrenet sa veriore dhe jugore, në Akulla - Foxhia, shkoi edhe më tej në Molise, ku punoi në Kompleksin e Kolegjit të Santa Maria Maxhores, të Xhulionezes, ndoshta edhe më gjerë, por të paktën në këto anë ne gjejmë edhe sot punimet e tij murale dhe në telajo, sigurisht me tematikë religjioze dhe të dedikuara në objektet e kultit.

Pa më të voglin dyshim, sikundër shprehet edhe kritika bashkëkohore italiane, "artisti shqiptar nga Vlora mbetet një figurë emblematike dhe një misionar me influenca të forta i kulturës bizantine, jo vetëm në territoret e Italisë jugore, por njëkohësisht dhe në vetë Rinashimentin italianë."



Vijon në faqen 14

P

PERSONAZH

Zbulimi i këtij personazhi është një ngjarje e bukur. Po e botojmë te "Milosao", ardhur nga profesori Koçollari, i njohur për skrupulozitetin e tij. "Që në vështrimin e parë të krijimeve të Vlonjatit, dallohet qartë prania dhe influencat e dukshme të artit bizantin, sa të formave, trajtave karakteristike luspative të ikonografisë, aq edhe të intensitetit të madh koloristik që rrallë mund të haset në artin e rilindjes italiane. Të gjithë këta elementë të bëjnë të mendosh se autori i ka marrë nga tradita e artit të lëvruar në atdheun e tij, ku stilitika bizantine ishte dominante, apo e thënë ndryshe ishte forma dhe përmbajtja e artit bizantin të kohës", thotë autori...

NJE PIKTOR NGA VLORA NE RILINDJEN ITALIANE

NGA PROF. DR. IRAKLI KOÇOLLARI*

Vijon nga faqja 13

Sigurisht, prania e veprave të Michele da Valonës ka qenë në ato anë për shekuj të tërë, por identifikimi dhe studimi veprave të mahnitshme të tij është shumë e vonuar. Kjo vonesë ka qenë e tillë për faktin se vetë studimet e vëmendshme dhe selektive për artistët e ardhur nga territoret ballkanase, dalmate, raguzjane, arbërore mbas pushtimit osman, kanë filluar vonë nga kritikët e artit figurativ në Italinë jugore.

"Vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të XIX u përpunua dhe mori formë ideja e hedhur nga Andre Kastel dhe pas tij nga intuïta brilante e Federiko Zerit dhe Pietro Zampeti, për kontributet e lindorëve, sipas të cilëve - terrenet bregdetare që shikojnë Adriatikon kanë manifestuar në vitet e Rilindjes tendenca apo prirje stilistike të të gjitha veçantive, me një karakteristike unike - me influenca të forta nga lindja ballkanase. Kjo kulturë ka tërhequr gjithashtu linjën nga realitetet e artistëve padovanë të pas shekullit të XIV dhe mandej ajo u zhvillua në të gjitha aspektet e autonomisë së saj." (Pietro Zampeti: "Carlo Crivelli, Giorgio Cullionivic, Nicola d'Ancona; - aspekti rinascimento adriatico - sec XV-XIX, S. Gracioti, Roma.)

Vetëm studimet dhe hulumtimet e thelluara të kësaj periudhe arritën të krijonin termat "format stilistike adriatikase" apo "Piktura adriatike" dhe "rilindja adriatike" (Zampeti), që tanimë janë koncepte të mara nga studiuesit e historisë së artit dhe tregojnë në mënyrë specifike format tipologjike të artit figurativ që lulëzuan në shekullin e XV përgjatë brigjeve të Detit Adriatik, nga të dy anët e tij, nga Istria në Pulian Italiane, nga Arbe në Raguzë, nga Boka e Kotorit", në Shkodër, Vlorë, etj. (L. Murillo: "Storias di una tavola - Michele Greco da Valona e il tritico di Cona di Mare", Roma). Megjithë pasojat fatale të pushtimit barbar, me gjithë rrënimin ekonomik dhe emigrimet e shumta të shkaktuara nga pushtimi osman, shpirti krijues ndër shqiptarët vazhdoi të pulsonte dhe krijonte. Në këtë periudhë dhe në vazhdim, gjenerata piktorësh të njohur dhe të tjerë anonimë, të pa studiuar ende, të tillë si Onufrit, vëllezërit Zografo nga Korça, Selimicasi e të tjerë, lanë vepra të mrekullueshme arti, që pasurojnë trashëgiminë unike të kulturës të vendit tonë.

**ADRIATIKU, NJË URË
LIDHËSE
PËR ARTIN E TË DY
BRIGJEVE**

Për të gjithë ballkanasit dhe



Michele Greco da Valona: "Madonna delle Grazie con i santi Sebastiano e Rocco"

Katalogu i veprave

Katalogu i veprave të Michele da Valona rendit në inventarin e tij një numër të kufizuar pikturash, pesë të tilla, por pa mëdyshjen më të vogël, me një profil krejt të veçantë në format kompozicionale, linjat anatomike të figurave, stilin dhe koloristikën tronditëse. Që në vështrimin e parë të krijimeve të vlonjatit, dallohet qartë prania dhe influencat e dukshme të artit bizantin, sa të formave, trajtave karakteristike luspative të ikonografisë, aq edhe të intensitetit të madh koloristik që rrallë mund të haset në artin e rilindjes italiane.

natyrisht pak më shumë për në shqiptarët kur përmendim Detin Adriatik, në kujtimet dhe imazhet tona përcillet vizioni i trishtë i hapësirave të ndaluara, të një koncepti gjeografik ndarës mes dy botëve, lindjes dhe perëndimit!

Nga një pellg dikur i përbashkët, nga hapësirë pa barriera për lëvizjet, këmbimet tregtare, komu-



nikim human, kulturor; të ideve, interesave, etj., deti Adriatik mbas pushtimit turk fatkeqësisht u kthye në një vijë fronti që ndante dy botë: Perandorinë Osmane, (për pasojë Ballkanin) me Evropën Perëndimore. Pas gati pesë shekujsh, reminishencat e asaj ndarjeje vazhduan gjatë. Ky det, Adriatiku, sot është ende shenjë e një kufiri të vështirë për komunikim, një hapësirë dhe faktor jo favorizues për lëvizjet dhe këmbimet e lira humane dhe kulturore.

Krejt e kundërta ndodhte me rrugët detare mbi këtë det, që favorizonin lëvizjet, të paktën gjer në shekullin e XV. Adriatiku ishte një hapësirë e përbashkët për popujt e brigjeve të të dy anëve, ishte një faktor dhe mundësi bashkëpunimi, për lidhjet dhe ballafaqime të shumta për protagonistë dhe destinacione të shumta të grupeve kolektive dhe dramave individuale.

Edhe në fushën e artit, Adriatiku ishte përgjatë mesjetës së vonë gjer në shekujt e XIV-XV një hapësirë e shkëmbimeve intensive të artistëve, të modeleve, tendencave dhe formave stilistike të larm-



Michele Greco da Valona: "Madonna con Bambino e i santi Pietro e Paolo"

ishme që lulëzonin në këto anë. Në radhët e tyre gjejmë jo vetëm piktorë por edhe arkitektë dhe skulptorë të famshëm, të cilët morën emër dhe i ofruan Rilindjes dhe humanizmit, botës italiane dhe më gjerë asaj evropiane vepra dhe krijime të rralla e të papërsëritshme, nga mjeshtro të tillë si Gjergji i Shebenikut, Laurana, Gjergj Dalmati, Shqiptari Andrea Aleks, Andrea Rizo, Bizamano, etj. (Daniele Ferrara: "Michele Greco da Valona nel Rinascimento Adriatico - pittori e committenti fra Oriente e Occidente."

MIHALI NGA VLORA

Një piktor që mërgon dhe krijon në Itali

Pikërisht, përmes ujërave të këtij deti, Adriatikut, veçmas në shekullin e XV, nga brigjet arbërore mbërritën në brigjet e Pulias dhe më gjerë në Gadishullin latin, një numër i madh familjesh fisnike, luftëtarësh që ishin ndeshur keq me forcat osmane, hallxhinj të dërmuar ekonomikisht nga barbaria osmane, por edhe intelektualë që nuk gjenin dot më, apo kishin humbur terrenin e ngrohtë të krijimit në këto vatra. Jo pak, nga radhët e intelektualëve arbërorë të mërguar lanë gjurmë në botën e madhe të Rinashimitos, ofruan talentin dhe bashkë me të vepra të mrekullueshme në gjuhë të ndryshme të artit, si pikturë, skulpturë, etj. Ndër ta tanimë duhet të renditet edhe Michele Greco da Valona - Mihal Ortodoksi nga

Vlora!

Sigurisht, së pari na duhet të sqarojmë një fakt që lidhet me identitetin e piktorit. Dhe burimi i vetëm por autentik duhet thënë se janë referencat mbi autografin që ai ka lënë si testament të padiskutueshme mbi nacionalitetin e tij, në pikturat që ai ka realizuar. Të gjitha punimet, pra të pesë tabllo, mbajnë nënshkrimin "Michele Greco da Valona", apo "Michele de Lavalona". Studiuesit italianë, sikundër Daniele Ferrara, Dora Catalano, Lucia Arbae, që janë marrë kohët e fundit me piktorin dhe tabllo të punuara nga ai, nënvizojnë qartë qenien shqiptare të mjeshtër. Termi "Greco" i vendosur pas emrit "Mihal" të piktorit nuk lidhet me nacionalitetin e piktorit, por me përkatësinë fetare të tij. Në këtë rast "Greco" do të thotë "ortodoksi". Është e njohur se kjo mënyrë të shprehuri dhe të shkruari ishte dhe është ende mjaft e përhapur në komunikimin, shkrimet apo dokumentacionin mesjetar. Ky term shërbente për të identifikuar "kristianët ortodoksë" përpara "kristianëve katolikë" në botën latine, por edhe më gjerë. Pra, e thënë ndryshe, apo e shqiptëruar, nënshkrimi "Michele Greco da Valona" do të thotë "Mihal Ortodoksi nga Vlora". E njëjta gjë ndodhte edhe me fenë islame. Në komunikimin gojor por edhe në shkrimet e mesjetës dhe gjerë në ditët tona përdorej dhe përdoret termi "turku" për një individ të besimit islam. Pra, edhe në këtë rast "turku" nuk nënkupton kombësinë turke të individit, por përkatësinë fetare islame të tij.

Ishte e nevojshme të vendosej ky cilësor "greku-ortodoksi", pasi në botën latine, katolike të kohës, minoranca lindore dhe për më shumë përkatësia fetare e ndryshme nga ajo vendase ishte një element identifikues i rëndësishëm. Aq e përhapur ishte njehsimi i termit "greku" që nënkuptonte "ortodoksinë", sa edhe sot e kësaj dite shpesh nga perëndimorët shkruhet dhe përdoret termi "kisha greke" - për "kisha ortodokse", apo "është e rritit grek" - për "është i rritit ortodoks".

Për identifikimin e origjinës së mjeshtër do të duhet të bëjmë evidente edhe një fakt interesant dhe të çuditshëm njëkohësisht, atë që artisti këmbëngul duke përsëritur në çdo tablo të tij se ai vjen nga Vlora, qytet port, me pozitë të rëndësishme strategjike, komerciale dhe ushtarake, të rëndësishme në bregun jugor të Arbërisë. Turqit e pushtuan këtë port të rëndësishëm në vitet 1480, kur flota turke rrethoi Otranton, dhe që prej atij moment, Vlora nuk e



...nga numri i shkuar

"Molisoa" e këtij numri mund të konsiderohet relativisht e mirë. Argumentin kryesor ia lëmë At Zef Pllumit dhe kundërshtitë e tij me komunitetin françeskan. Interesant është se tashmë pas vdekjes, klerikut, i atribuon shumë gjera, por nuk realisht gjërat që ate e shqelësonin dhe që ai i ngriti si probleme. At Zef Pllumi është një nga klerikët që ka vuajtur më shumë nga të gjithë në burgjet komuniste. Por surpriza do ta prishte kur ai do të ngrihej. Vërtetë në sistemin e ri, atij do t'i njiheshin vuajtja veçse duhet të pohojmë se nuk ishte se kishte aq marrëdhënie të mira me Urdhrit e vet. Redaktori e ka takuar dhe intervistuar në të gjalle dhe solli shqetësimet e tij, por

edhe dy letra institucionale letërkembimi, ku ai kërkon para për botimin e françeskanëve dhe një shpeshkronje.

Nga numri i shkuar, "Molisoa" filloi botimin e një cikli të gjatë kushtuar poetit Dritero Agolli, përgjithësisht nga Shpetim Çucka, përkythjes dhe publicist. Autori ka punuar për disa javë mbi figurën e personalitetit të njohur të letërave shqipe për ta paraqitur me të gjithë larmërinë e mundshme. Në fakt, duket se nisjen e mori në momentin, kur autorit të ndërjeu iu dedikuan pa fund ditërambe dhe figura e tij pati shumë apozeoza por edhe njerëzime. Nuk u tha realisht thelbi, mëlon përkythjes i njohur.

Moikom Zeqo rivjen sërish në faqet e "Molisoa" me një cikël. Autori kishte mbetur i

pakënaqur për faktin sepse shkrimi ishte me gërma shumë të vogla dhe gati i palexueshem, sipas tij. Duket se nuk e vlerësonte hapësirën prej dy faqesh që i ishte lënë.

Krejt ndryshe, megjithë vonesën e madhe, muzikologu Sul Gragjevi e vlerësoi botimin e shkrimit të tij dhe ishte shumë i gazmuar. *Opera "Jevgenji Onjegin" e Çajkovskit, është një opera e veçantë apo speciale, në të cilën dashuria është tema, karakteret dhe situatat sillen rreth aspekteve të dashurisë. Pra, dashuria është arsyeja që vëmendja përqendrohet në ata karaktere dhe çare ndodh me ta. "Onjegin" është shkruar nga një kompozitor i cili është futur thellë në kulturën Perëndimore të Europës, shkroi ai.* Vete redaktori shkroi dhe një shkrim për një

prozator malazez. Shkrimtari bashkëkohor malazias Vladimir Vujanović ndau emocionet dhe përshypjetet e tij në një mbremje letrare në Tiranë, organizuar nga POETIKA, pak ditë më parë. I shoqëruar nga shkrimtari i njohur malazez me origjinë shqiptare Jovan Nikolaidis, ai iu përgjigj shumë pyetjeve për bashkëkohësin e letërsisë së solme malazeze, gjuhën e vendit të tij në letërsi dhe debatet e ndryshme në vend, që lidhen me të...

Mendojmë se numri ishte i mirë relativisht, edhe pse kërkonte pak më shumë lami. Layout punoi shpejt dhe me përgjegjësi, por zgjidhjet grafike, nuk ishin aq mbresëlënëse sa prisnim prej autorit të grafikes.

mori më veten si port dhe bazë aktive detare.

Gjykojmë që është logjike të mendosh se - një artist që detyrohet të largohet nga atdheu prej një pushtuesi të egër, - sigurisht, veç mallit dhe nostalgjisë ai merr dhe gatuan në përditshmërinë e endrrove dhe emocionit këmbënguljen për të mos e braktisur atë shpirtërisht. Nën këtë logjikë mund të ngremë pyetjen: - Mos vallë përsëritja e nënshkrimit, "Michele Greco da Valona", në fund të çdo tabloje, përveç pretendimit të autorësisë së veprës dhe dinjitetit të mjeshtërisë, kishte qenë një gjest i piktorit për të kujtuar veten, qytetin e origjinës nga vinte dhe gjithashtu për të informuar në mënyrë pragmatike se ku duhen bërë gjurmimet ?!

Nëse do të bënim një paralele, duhet të kujtojmë se arbëreshët emigrant në vendosur në Kalabri bënin të njëjtën gjë ndërsa krijonin këngët e tyre. Ata thërrisnin në përditshmërinë e tyre, përmes artit të poezisë, vendin e origjinës, prej nga ata kishin emigruar, Morenë (Peloponezin): "Moja e bukura More!"

Të njëjtën gjë bëjnë edhe piktorit vlonjat, kujton përmes autografëve të lena në tablot e tij, atdheun e lenë pas, nga ku kishte emigruar - Vlorën (da Valona)!

VEPRAT E PIKTORIT VLONJAT, NJË RISI NË ARTIN E RINASHIMENTOS

Katalogu i veprave të Michele da Valona rendit në inventarin e tij një numër të kufizuar pikturash, pesë të tilla por pa mëdyshjen më të vogël, me një profil krejt i veçantë në format kompozicionale, linjat anatomike të figurave, stilin dhe koloristikën tronditëse.

Që në vështrimin e parë të krijimeve të Vlonjatit, dallohet qartë prania dhe influencat e dukshme të artit bizantin, sa të formave, trajtave karakteristike luspative të ikonografisë, aq edhe të intensitetit të madh koloristik që rrallë mund të haset në artin e rilindjes italiane. Të gjithë këto element të bëjnë të mendosh se autori i ka marrë nga tradita e artit të lëvruar në atdheun e tij, ku stilistika bizantine ishte dominante, apo e thënë ndryshe ishte forma dhe përmbajtja e artit bizantin të kohës. Por, sigurisht tablot e Mihalit nga Vlorë, veç tradicionales, tipikes bizantine, të ngjizura dhe të importuara në shtegtimet e tij si mërgimtar, bartin dukshëm influencën dimensionale të artit të Rilindjes italiane, atë art që i japin veprave të vlonjatit përmasat e humanizmit, që gjallonte ato kohë shpirtin dhe karakterin e epokës së Rinashimentos. Figurat e shenjtoreve, të Shënjtore Mari dhe e shenjtoreve të tjerë që shoqërojnë temat biblike të pesë tablove të



Michele Greco da Valona: "Madonna con Bambino tra santa Caterina d'Alessandria e san Nicola di Bari"

mjeshtër vlonjat, janë të përafërara në stil, teknikë dhe gjer në dinamikën anatomike, qartazi me artin e Rilindjes italiane.

Sikundër përmendim, nga krijimet e mjeshtër gjer më tani janë identifikuar dhe ruhen vetëm pesë tablo të tij dhe ato janë:

1. Madonna con Bambino tra santa Caterina d'Alessandria e sa Nicola di Bari - 1505
2. Madonna con Bambino tra san Giovanni Battista e sant'Adamo - 1505
3. Assunzione della Vergine e San Tommaso - 1505
4. Madonna delle Grazie con i santi Sebastiano e Rocco - 1505
5. Madonna con Bambino e i santi Pietro e Paolo - 1505

Duke i parë me vëmendje tablot, kohën e krijimit të tyre, si dhe një kontrast që tregon qartë se kush është porositësi i disa prej veprave të vlonjatit, mësojmë disa fakte interesante. Së pari se ishte tregtari Cola Bevilacqua që më 1 Janar të vitit 1505 ka kërkuar nga mjeshtër realizimin e tre tablove kundrejt një shpërblimi të caktuar financiar. Së dyti; mësojmë faktin se të tre këto tablo me dimension relativisht të mëdha janë punuar nga piktori prej muajit Qershor gjer në muajin Shtator të vitit 1505, çka flet qartë për një aktivitet mjaft intensiv krijues dhe sigurisht na jep të drejtën të mendojmë se "da Valona" duhet të ketë pasur një krijimtari mjaft të begatë, pra numeroze, të cilën në fat-

keqësisht nuk e kemi apo ende nuk është identifikuar. Së treti, autori të paktën për dy vite, që prej vitit 1504 dhe gjer në fund të vitit 1505 ka qenë në zonën bregdetare të Gjuqinesës dhe pak më vonë në Cona, në bregdetin e Vastos.

Aktiviteti i këtij artisti, nese e krahasojmë me atë që ka ndodhur përgjatë Adriatikut verior të Italisë, në raport me territoret e Mbretërisë së Napolit, ku kishte shumë shqiptarë dhe dalmatë, pavarësisht nga dasitë katolike apo ortodokse, është krejt e evidente krijimtaria dhe stili karakteristik i "Vlonjastit" në raport me gjithë të tjerët. Studjuesit e artit Italian që janë marrë me krijimtarinë e



vlonjatit, sikundër Lucia Abracce nënvizon: "Ka një karakter mbitzërues dhe shprehje origjinale krijimtaria artistike dhe veçmas piktura e zonave bregdetare të Adriatikut jugor të Italisë në raport me veriuin, në periudhën e Rilindjes. Kjo sigurisht ka ardhur si pasojë e këtyre emigrimeve, e këtyre këmbimeve, të cilat krijuan terrenin për një "shtrirje ndër-kulturare" dhe "ndërkulturore" të artistëve dhe të artit të tyre, pikturës. Aspekti më relevant për krahinën e Molizës është prania në këtë vend i veprave të "Michele da Valona", më konkretisht ato në qytetin e Xhulionezes (Gugliunese). Tabloja e këtij mjeshtër në katedralen e këtij qyteti që paraqet "Madonën me fëmijën në duar dhe në krah Shën Xhovani Batistën (Shën Gjon Pagëzorin), është një nga shembujt më sinjifikativë."

PIKTORË TË TJERË SHQIPTARË TË PANJOHUR NË BREGDETIN E MOLIZES, NË SHEK. XV-XVI

Një tjetër prani e piktorëve shqiptarë të shekullit të XV dhe e tablove të tyre gjenden në qytezën e Kampomarinos në bregdetin e Molizës. Është fjala për disa afreske të mrekullueshme, që specialistët e artit e kanë të vështirë ti datojnë saktësisht, gjenden në Kishën e "Shën Mërisë së Detit" në qytezën e Kampomarinës (Kampobaso). Në të paraqiten shenjtoret, Shën Dhimitri, Shën Nikola dhe Shën Pjetri, në krah të të cilëve ruhen edhe mbishkrimet në gjuhën greke, (bëjmë me dije se të gjitha mbishkrimet në afresket e kishave kristiane ortodokse, në të gjithë hapësirat e perandorisë Bizantine, nën kufijtë e të cilës gjendej edhe vetë Shqipëria, hartoheshin në gjuhën greke, gjuha zyrtare e kësaj perandorie).

Këto piktura (afreska) që ilustronin këtë objekt kulturi arritën të mbijetojnë që prej shekullit të XV gjer në kohët tona dhe u gjetën vetëm në vitin 1982, kur një ekspeditë restauruese gjeti nën shtresat gëlqerore dhe suvanë tablot e përmendura. Nuk përjashtohet që tablot të jenë realizuar nga piktorët shqiptarë pas inkusioneve barbare që ndërmorën osmanët në vitin 1519 në këto anë.

Paraqitja e shenjtoreve në këto afreske, për nga trajta e punimit të ikonografisë dhe kompozicionit nënvizojnë në thelb traditën e pikturës lindore por natyrisht në të dallohen edhe influencat e pikturës së rinashimentos italiane. Prania e figurave dhe fizonomisë turke si dhe e ushtarëve me armatimi dhe kuajt e tyre të luftës janë element që i gjëjmë edhe tek Mikeli nga Vlorë.

Po ashtu, figura e Shën Dhimitrit është ajo e një shenjtori mjaft present në afresket e kishave kristiane shqiptare dhe pak më gjerë. Ky

shenjtore paraqitet përherë i veshur me uniformën e luftëtarit me armatim dhe në kalë, sikundër po aq i pranishëm është tek këta piktorë edhe prania e Shën Gjergjit, edhe ky përherë në paraqitjen e një luftëtarit të armatosur dhe me kalin e luftës pranë, apo hipur mbi të.

Në afreskun që përmendim më sipër të kishës të Shën Mërisë së Detit të dy shenjtoret që përmenden janë vendosur nga piktori shqiptar krahu njëri tjetrit. Në mënyrë simbolike në tablo paraqitet edhe turku, i cili ka marrë një goditje të tmerrshme në gojë, nga Shën Dhimitri. Shkëna e goditjes vdekjeprurëse me hushhtën e gjatë në gojë, është e ngjashme me ato që kemi parë në tablo të tjera por me të vëmin ndryshim që luftëtarit që jep goditjet kuqederës apo dragoit është Shën Gjergji. Kjo skenë lufte në afreskun mural të kësaj kishë, pa dyshimin në të vogël është një skenë simbolike dhe metaforë e fortë e qëndrës së Gjergj Kastriotit kundër pushtuesve osmanë." (Paolo Moriello dhe Marilena Cozzolino - Universita di Molise - restauro pitorico.)

SHËN GJERGJI DHE GJERGJ KASTRIOTI

Por, figura e Shën Gjergjit ndër shqiptarët, mbas qëndrës së njohur të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti kundër pushtuesve osmanë mori të tjera përmasa dhe vlerësim, tanimë jo vetëm në dimensionin literal religjioz, si figurë e një shenjtori në radhë të shenjtoreve të kristianizmit, por ai filloi të identifikohet edhe me vetë heroin tonë Gjergj Kastriotin. Kishte disa arsye që ndër shqiptarët ky shenjtore të identifikohet me Shën Gjergjin, ndërsa ilustrueshin dimensionet murale dhe ikonostasat e kishave apo katedraleve në Arbëri dhe në Itali.

Sipas rrefënjes kristiane, Shën Gjergji ishte luftëtar trim, i cili paraqitet përherë në ndeshje me të keqen, një kuqederë të cilën e mposht fatalisht duke i ngulur hushhtën në grykë dhe mandej duke e qëlluar me shpatë. Sigurisht, të njëjtën gjë kishte bërë edhe heroit ynë, ai për 25 vite ishte ndeshur me të keqen, Perandorinë Osmane dhe e kishte dalë fitimtar. Simetria në këtë simbolikë ishte e bukur, e përshtatshme dhe frymëzuese për shqiptarët. Është kjo arsyeja që tablot dedikuar Shën Gjergjit i gjejmë kudo ku kishte emigrant shqiptarë apo stratiotë (luftëtarë shqiptarë në formacionet ushtarake të ushtrive perëndimore), në territoret italiane, nga jugu, Sicilia, Kalabria dhe gjer në veri, në Venecia.

Le të shpresojmë se kërkimet e mëtejme për Vlonjatit Mihal do të na ofrojnë të tjera vepra dhe të tjera të dhëna me interes për të, apo artistë të tjerë shqiptarë që kanë derdhur talentin e tyre në tokën e Rinashimentos apo edhe më gjerë, në atë europiane.

Prof. Dr. Irakli Koçollari

A

ARGUMENT

Autori, në këtë copëz, hedh një vështrim për mëdyshjen e autorit. "Një vlerësim i gjithanshëm dhe i vëmendshëm, pa kufizime dhe metafizikë botëkuptimore, do të gjejë patjetër – dhe pa shumë vështirësi – thelbin e tyre: flamujt e ëndrrës së madhe të çlirimit të vendit dhe të një shoqërie të mbështetur mbi parimet e barazisë dhe drejtësisë shoqërore, flamuj të ëndrrës së djalërisë, rinisë dhe burrërisë, në fakt të të gjithë jetës, së Dritëro Agollit, flamuj që ai i ka mbajtur përmes vështirësisë dhe kurrë nuk i ka hedhur, as në klimën e një kohe të sahartë, të shkretëtirtë", shkruan autori...

Dritëro Agolli përballë socializmit

NGA SHPËTIM ÇUÇKA*

Vijon nga numri i shkruar

6.

Le të shohim tani periudhën e rinisë dhe burrërisë së autorit në krijimet letrare përkatëse.

Sot te ne, kur vjen fjala për këtë periudhë, është bërë modë të përmenden romanet "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo", "Arka e djallit", "Kalorësi lakuriq", dhe tregimet e përmbledhura në vëllimin me titull "Zhurma e erërave të dikurshme". Asgjë tjetër: Asgjë. Nënvizohet fakti që mbi këto vepra u ndie pesha e censurës së shtetit, flitet për suksesin e botimit të "Zylos" në vendet e tjera. Këtu pak a shumë përmbledhen meritat e këtyre veprave. Kritika e huaj ka vënë në pah edhe ngjashmëritë e romanit "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo" me krijime të përafërta në vende të tjera, ngjashmëri të tematikës, të stilit etj. etj.


Po të shqyrtohen me vëmendje ato që janë shkruar e thënë për romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo" apo edhe për tregimet e përmbledhura në vëllimin "Zhurma e erërave të dikurshme", të krijuhet bindja se këto vepra shihen nga një pikë e vetme: kjo prozë e Dritëro Agollit është shprehja e kundërvënies së tij – qoftë edhe të kujdesshme – ndaj sistemit politik dhe realitetit të kohës.

Në të vërtetë nuk është e domosdoshme njohja nga afër me autorin për ta përcaktuar me siguri një pohim të tillë. Kur sistemi socialist u shemb (apo e rrëzuan?), inteligjencia e vendit, e të gjitha fushave, veçanërisht zjarrtas ajo e artist dhe kulturës, e përqafoi në masë dhe me entuziazëm atë proces historik. Dhe është e lehtëkuptueshme që mbështetja e inteligjencës për shembjen e sistemit (domethënë për rrëzimin e tij) nuk nisi ato ditë dimri 1990. Inteligjencia kishte kohë që mendonte vetëm për vete dhe ëndërronte fitime të majme, krijime sipas gustos së botës së huaj, komoditete, pushime turistike, jetesë si jashtë shtetit ose edhe jetë jashtë shtetit.

Pakënaqësia e Dritëro Agollit me realitetin e kohës gjen shprehje edhe në të tilla vargje ("Poema e njeriut të zemëruar", 1992-1994):

Rinia ime, të kisha ikur edhe unë bashkë me ty,
T'i merrja me vete në varr edhe ëndrrat e kaltra,
Mos kisha parë këtë gjysmë shekulli ndotje me sy,
Mos kisha parë llumra kënetë, krimba e larva!

Ose edhe në prozë (Dane Ga-



Dritëro Agolli - Fjeda Zyrtara (Courtesy Image - Social Media)

jtani, "Kalorësi Lakuriq"):

"Mua të gjithë ju më jeni neveritur. Të gjithë: akademikët, gratë, drejtuesit, rrugët, qytetet, kalimtarët... Ngado shoh lajkatarë dhe hipokritë që fshehin të vërtetën, që mizerjen e quajnë arrijtje, që ligjet absurde ekonomike e shoqërore i bazojnë teorikisht për të justifikuar varfërinë dhe për t'i vënë këto ligje e këto parime në vitrinat e dyqaneve në vend të ishit, qumështit, djathit dhe patateve... Xhungël lajkatarësh dhe gjenjeshtarësh!"

Nuk është vallë kundër sistemit të kohës? Ç'është e vërteta, vepra u përfundua në vitin 1995 dhe e pa dritën e botimit në vitin 2016. Në të, në të gjithë lëndën e saj, ndihet fare qartë që është përfunduar dhe shkruar në mënyrë përfundimtare dhe të padallueshme gjendja shpirtërore e autorit në këtë periudhë të fundit, aq sa nuk mund ta ndash se cilës kohë i përkasin këto apo ato përjetime dhe përsiatje. Gjithçka tingëllon në përkim me vitet 1979-1995 shënuar në fund të veprës.

Por po këtu në fund janë vënë edhe vargjet:

Ju flamujt e mi, lamtumirë,
Ju flamujt gjakosur e grisur,
T'ju mbaja ka qenë e vështirë,
T'ju hidhja s'kam qenë i lajhtitur.

Ndaj vdisni në guzmët e gërryura,

Përzihni mes hirit dhe rërës
Dhe shtrihni me shtiza të thyera
Në shkallët e verdhra të hënës

Atje në Saharën e Ëndrrës...

Dhe temat e këtyre vargjeve me

Përballë burokracisë

Konkretisht burokratizmin, domethënë, punën e zyrave të shkëputura nga jeta e gjallë, dhe frazimin, siç e cilësonte jo rrallë Dritëro Agolli në fjalimet dhe shkrimet e tij letraro-politike këtë pamje dhe shfaqje ndër më të dukshmet e burokratizmit, domethënë përdorimin e togjalëshave dhe shprehjeve gjuhësore të ngurtësuar, të spërdredhura dhe pa përmbajtje konkrete. Të dyja këto dukuri paraqiten në roman të shoqëruara nga dukuria e tretë, e padukshme, e punës së mefshtë të zryave: hartimi i fjalimeve dhe artikujve të shëfave të zryave nga vartësit e tyre.



ngjyresë të fortë tragjike janë: flamujt e gjakosur e të grisur me shtizat e thyera dhe Saharaja e Ëndrrës.

Lexuesi mund t'i përfytyrojë dhe zbërthejë sipas mendjes së tij këto simbole poetike. Por një vlerësim i gjithanshëm dhe i vëmendshëm, pa kufizime dhe metafizikë botëkuptimore, do të gjejë patjetër – dhe pa shumë vështirësi – thelbin e tyre: flamujt e ëndrrës së madhe të çlirimit të ven-

dit dhe të një shoqërie të mbështetur mbi parimet e barazisë dhe drejtësisë shoqërore, flamuj të ëndrrës së djalërisë, rinisë dhe burrërisë, në fakt të të gjithë jetës, së Dritëro Agollit, flamuj që ai i ka mbajtur përmes vështirësisë dhe kurrë nuk i ka hedhur, as në klimën e një kohe të sahartë, të shkretëtirtë.

Ne nuk mund të mos arrijmë pikërisht këtu, në këtë përfundim. Dhe nuk mund të mos e shikojmë nga ky këndvështrim të gjithë veprën letrare të Dritëro Agollit, të gjithë veprimtarinë e tij qytetare e shoqërore.

Dhe atëherë para ndërgjegjes sonë shoqërore e qytetare – nëse kemi një të tillë – do të shpaloset e vërteta e madhe e poemave të Dritëro Agollit, e të gjitha poemave të tij të epokës socialiste: "Poema e udhës" (1957), "Mendime në vjeshtë" (1960), "Dhjetë sy" (1960), "Poema e të pagjumëve", "Dashuri dhe ferobeton" (1962), "Poemë malore" (1962), "Devoll, Devoll" (1964), "Baladë e re për komisararin" (1964), "Rebelimi i parë", "Toka ime, kënga ime" (1967), "Baladë e ashpër" (1968), "Baballarët" (1969), "Komunistët" (1971), "Nëntoriada" (1976), "Nënë Shqipëri" (1974), "Poemë për babanë dhe për veten" (1956, 1984).

7.

Por më parë le të ndalemi pak edhe te romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo". Këtu e më tej nuk do të mbahen parasysh vlerësimet e personaliteteve të huaja. Pse? Për arsyen e thjeshtë së Dritëro Agolli, si pjesa më e mirë (jo më e madhe!) e shkrimtarëve tanë dhe si pjesa më e mirë edhe e shkrimtarëve të vendeve të ndryshme, ka shkruar për popullin e tij e jo për publikun e huaj. Dhe

fjala e mirë e popullit vlen pakrahasimisht më shumë se lëvdatat e të huajve, sado të singërta – pale më pastaj të mençura! – qofshin këto të fundit.

Ndërkombëtarizimi i artit dhe letërsisë ka qenë dhe mbetet një proces i mirëfilltë ndikimi politik, sa herë që ai në një mënyrë a tjetër i është diktuuar së jashtmi një shoqërie. Dhe sot ai është hap-tazi pjesë e procesit të globalizimit, i cili nën parullat ndjellëse për përparim (në ç'drejtim?), liri (nga kush a ç'gjë?) e të drejta (të individit kundër shoqërisë?) aq trazira e të zeza u ka sjellë shumicës së vendeve e popujve.

Çfarë dallon shqiptari i vëmendshëm (prania e të cilit në shoqërinë tonë duket se ka vajtur duke u rraluar) te romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo"? Një pasqyrë të disa trajtave të gabuara, po edhe të shëmtuara, të punës administrative në sistemin socialist. Konkretisht burokratizmin, domethënë, punën e zyrave të shkëputura nga jeta e gjallë, dhe frazimin, siç e cilësonte jo rrallë Dritëro Agolli në fjalimet dhe shkrimet e tij letraro-politike këtë pamje dhe shfaqje ndër më të dukshmet e burokratizmit, domethënë përdorimin e togjalëshave dhe shprehjeve gjuhësore të ngurtësuar, të spërdredhura dhe pa përmbajtje konkrete. Të dyja këto dukuri paraqiten në roman të shoqëruara nga dukuria e tretë, e padukshme, e punës së mefshtë të zryave: hartimi i fjalimeve dhe artikujve të shëfave të zryave nga vartësit e tyre.

Është e qartë që të tria këto dukuri, të lidhura e të ndërvarura mes tyre, e kanë ngacmuar deri në dhembje vëmendjen dhe ndërgjegjen e D. Agollit, që për hir të veprimtarisë shoqërore ka pasur mundësinë të shohë këto e plot të meta e dobësi të tjera më të lehta a më të rënda. Në shoqërinë socialiste, të veçuar nga ndikimet – rrallëherë të mira e dashamirëse – të vendeve perëndimore, klima shoqërore dhe ajo e marrëdhënëve të zyrës të paraqitura në romanin "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo", shiheshin si diçka e dënueshme. Këtu edhe qëndron-te vlera e romanit për atë kohë.

E sotmja, kur qindra mijëra shqiptarë u vendosën për të jetuar pikërisht në vendet e qytetërimit perëndimor dhe kur ndodhemi çdo ditë e disa herë në ditë nën bombardimin e lajmeve dhe të deklaratimeve të politikantëve të huaj e jo vetëm vendës, burokratizmi dhe frazimi na janë shpalosur si dukuri të rëndomta, të përhapura gjerësisht dhe aspak të qortueshme, përkundrazi të veshura me një tip aristokratizmi, i cili jo rrallë i duket shumë tërheqës një numri jo të vogël banorësh të

P

PERSONAZH

NGA BEN ANDONI

Le të shpresojmë që Robert Elsie ta lenë të qetë. Jo se nuk e kemi lënë të qetë deri më tani, porse për shumë shqiptarë ai ka qenë thjesht një studiues, nga të shumtë, që merret me shqipen dhe shqiptarët, dhe që kështu jeton. Po, kështu jetonte vërtetë. Ai e kishte pohuar vetë këtë dhe madje subvencionet për punët e veta, kryesisht dedikuar Shqipërisë, i gjente ngado, por pa i bezdisur institucionet shqiptare. Ashtu si merret me mend, nga ditëvdekja e tij kanë filluar homazhet mediatike, kurse armata e shpifëve nuk ka reshtur pa e atakuar edhe kujtimin e të ndjerit. Thelbi: jo thjesht puna e tij, porse qasja e tij ndaj habitatit shqiptar. I ndjeri, në intervistën që ka dhënë kohë më parë për Rudina Xhungën, kur ishte pyetur nëse do mund të lidhej me shumë me Shqipërinë dhe do të jetonte në vend ishte shprehur: "Unë nuk mund të jetoj këtu. Është një vend pak i egër për mua, marrëdhëniet midis njerëzve janë pak të egër. E di që është vetëm një fasadë se brenda e kanë shpirtin e mirë, por kanë një egërsi në marrëdhëniet njerëzore. Ju dini të mbroheni këtu, ndërsa unë këtu jam si lepur; nuk di të mbrohem. Unë vij këtu me shumë kënaqësi, por nuk besoj se mund ta përballoj të vij të je-


E gjithë kjo punë e tij, më shumë pati jehonë ndër të huaj sesa vendasit. Këta të fundit e vlerësonin, më së shumti, kur ai i përmendte në punët e tij ose i përkthente. Në rast se nuk e bënte këtë, ai ishte thjesht një Robert Elsie, një qytetar kanadez me origjinë gjermane, që dinte mirë anglisht. Sa ishte gjallë, besoj se të rrallë do kenë qenë shqiptarët që do e kenë pyetur ndonjëherë: Po ne si mund të ndihmojmë?! Ne nuk e bëjmë sepse jemi të interesuar thjesht për egon tonë dhe sëmundjen kombëtare për të qenë në qendër të gjithçkaje. Pra, tani ta lëmë të qetë Elsie! Se për ta harruar do e harrojmë sa të futet në dhë.

Robert Elsie, e lëmë të qetë, ashtu si nuk e përmendëm kurrë

toj përgjithmonë këtu. Ka shumë frustracion të jetës së përditshme. Jeta është shumë e shkurtër e unë nuk kam kohë të përplasem në pengesa, vetëm për të arritur diçka, kur në një vend tjetër e arrij menjëherë dhe pastaj jetoj jetën time. E di që ju kaloni shumë kohë në ditën tuaj me pengesat që ju dalin përpara dhe kjo ha shumë kohë. Për shembull, po të jetoja këtu do të kaloja sigurisht gjithë ditën duke pirë në një kafe sepse do të më lajmëronin njerëzit hajde të pimë kafe dhe nga një kafe gjysmë ore, ajo do të shkonte një orë, dy orë, tre orë, katër orë dhe gjithë dita do të shkonte në kafe. Kurse unë jetoj një jetë pak të veçantë dhe nuk kam shumë shoqëri. Kjo është preferencë ime, unë jetoj me librat e mi, me idetë, projektet e mia dhe kënaqem me to.

Pastaj po të jetonit këtu do të merreshit shumë me politikë. Do duhej patjetër të ishit me njërin palë ose tjetërën përndryshe do të ishte shumë e vështirë të jetonit si asnjëherë apo i paanshëm".

Paçka se neve nuk na pëlqen, në këtë pasazh, gjendet pak a shumë ajo që ndodh me ne, ajo që mendohet për ne dhe ajo çka jemi.



Robert Elsie

Ajo nuk ka lidhje as me qeverisjen e shkurtër të Ismail Qemalit dhe pushtetin e Esat Pashës, sundimin e Ahmet Zogut dhe diktaturën e Enverit, tollonin e Berishës dhe autoritarizmin modern të Edi Ramës, por me vetë mënyrën e jetesës së shqiptarëve në shekujt e fundit. Ajo është e

pa ndryshueshme dhe ajo ndikon në strukturën e mendimit, por edhe me të gjithë mënyrën sesi shqiptarët përballin shtetin e tyre.

Larg këtyre, vdekja e parakohshme e Elsie paraqet realisht një humbje duke llogaritur kontributin që ky personalitet mund të jepte për kulturën tonë ko-

mbëtare, studimet letrare, sjelljen moderne të historisë së letërsisë dhe vetë disiplinave të historisë, për kontributet në koleksionet fotografike, por edhe antropologjinë. Interesat e tij ishin të shumë-ana dhe kjo realitet e bënte tejet interesant qasjen e tij shqiptare. Ndaj ai botoi histori letërsie, histori, antropologji, poetë dhe shkrimtarë nga viset shqiptare, të gjitha falë anglishtes së tij të përsosur profesionale, por mbi të gjitha respektit për veten e tij, që ai e gjeti të lidhur me Shqipërinë.

Megjithatë, e gjithë kjo punë, më shumë pati jehonë ndër të huaj sesa vendas. Këta të fundit e vlerësonin, kur ai i përmendte në punët e tij ose i përkthente. Në rast se nuk e bënte këtë, ai ishte thjesht një Robert Elsie, një qytetar kanadez me origjinë gjermane, që dinte mirë anglisht. Sa ishte gjallë, besoj se të rrallë do kenë qenë shqiptarët që do e kenë pyetur: Po ne si mund të ndihmojmë?! Ne nuk e bëjmë sepse jemi të interesuar thjesht për egon tonë dhe sëmundjen kombëtare për të qenë në qendër të gjithçkaje. Pra, tani ta lëmë të qetë Elsie! Se për ta harruar do e harrojmë sa të futet në dhë.

qyteteve tona. Na ka qëlluar aq e aq herë të dëgjojmë politikantë të Evropës e jo vetëm të Kuvendit tonë, që përdorin publikisht atë që shtypi e cilëson si "gjuhë e drunjtë". Lexuesit të vëmendshëm nuk mund të mos i shkojë mendja e të bëjë një krahasim midis gjuhës së Zylot dhe gjuhës së drunjtë të elitave të sotme. Nuk do të ishte aspak çudi që nga një krahasim i tillë kjo gjuha e dytë t'i tingëllonte shumë më e spërdredhur e më e zhveshur nga përmbajtja konkrete, përveç që e ngarkuar me gjithfarë shprehjesh të ngurtësuar, për të cilat, po të pyesësh përdoruesin e radhës, do të të japë kuptime nga më të çuditshmet, por asnjëherë të njëjtat.

Dhe sa për faktin që Demka duhej të shkruante fjalimet dhe artikujt që i nevojiteshin Zylot, lexuesit të sotëm nuk do t'i ketë shpëtuar nga vëmendja fjala me tingëllim modern "speechëritër" (fjalimshkrues). Veçse çuditërisht ky term nuk duket i shëmtuar, sikurse duket veprimtaria fjalimshkruese e Demkës së kohës së socializmit. A thua ka sot ndonjë president, kryetar Kuvendi, kryeministër, deputet a ministër, tek ne dhe në botë qoftë, që i shkruan vetë fjalimet që do të mbajë? Po edhe në pastë ndonjë, ky është përjashtim që përforcon rregullin. Ja, pra, si na qenkësh raportit



ndërmjet Demkës së djeshmë dhe fjalimshkruesve të sotëm! Ai ishte pjesëmarrës në një shfaqje të dënueshme (se ky ishte efekti i romanit!), ndërsa këta sot zhvillojnë një veprimtari të leverdisshme, përveç që të privilegjuar. Ajo që dje dënohej moralisht, sot shpërblehet materialisht dhe nuk është asfare e dënueshme!

Dhe na vijmë ndër mend këtu vargjet e poezisë së hollë "S'ka asgjë për të qeshur" të D. Agollit:

Ja, e vërteta rri lakuriqe ngaherë,

Ja, dhe gënjeshtria me petka rri

veshur!

Më thoni: cila ka turpin dhe cila ka ndërë?

Kjo që ju thashë s'ka gjë për të qeshur.

Shoqëritë perëndimore nuk kanë si të qeshin Zylot dhe Demkën e shoqërisë socialiste shqiptare. Konvejeri i Zylot dhe Demkave të tyre është i paarrtshëm! Dhe një element shumë i rëndësishëm për të vlerësuar shkallën e afërsisë së pushtetit me popullin (nuk po përdorim këtu termin "demokraci" për shkak të shpërdorimit të përbindshëm që i

Mjeshtëria e ndërtimit të personazheve

E gjithë mjeshtëria e Dritëro Agollit, në të gjithë prozën e tij më të mirë, atë epike, qëndron në ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy tipeve të shqiptarëve: shqiptarëve-Rrapo dhe shqiptarëve-Memo, ndërmjet dy brezave, burrave dhe të rinjve. Dhe këtu nuk ka rëndësi aspak se cilat modele mund të ketë pasur parasysh autori, kur skaliste të tilla karaktere. Në të vërtetë përvoja e tij jetësore ka qenë e mbushur me shembuj ngjarjesh dhe njerëzish të denjë.

është bërë atij në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare), për të vlerësuar shkallën e komunikimit të kuptueshëm të organeve të shtetit me popullin, është pikërisht fryma e vetëkritikës që e gjithë shoqëria – duke filluar nga organet më të larta – shpreh dhe shfaq në jetën e përditshme. Po japim një shembull kuptimplotë se si e vlerëson një autor gjerman në gjysmën e parë të shek.XIX lirinë e shtypit në vendin e tij:

"Ne, - vazhdon më tej gojëtarin, - do ta lejojmë atë (publikimin e debateve të mbajtura në kuvendin krahinor – Sh. Ç.) atëherë, kur ta

shohim të arsyeshme, dhe do ta kufizojmë atëherë, kur kjo të na duket e padobishme, madje e dëmshme. Ne do të bëjmë si të duam. Sic volo, sic jubeo, stat pro ratione voluntas (Kështu më pëlqen e kështu urdhëroj të bëhet. Në vend të arsyes është vullneti im). Kjo është me të vërtetë gjuha e sundimtarëve, e cila fiton një ngjyresë mallëngjyese në gojën e dinjitarit të sotëm".

Si paraqitet sot çështja me të vërtetat publike – në rastin konkret me vetëkritikën – në vendet që vetëquhen dhe që është bërë zakon të cilësohen si demokraci? Ia vlen të gjurmohet kjo dukuri, përpara se të dëgjojmë e të mirëpresim me përlulje mendimet që na vijmë nga përfaqësues të këtyre vendeve lidhur me çështjen se si kanë qenë te ne rastet e Zylotve me Demkat. Gjurmimi i dukurisë së qëndrimit që mbahet në këto vende ndaj të vërtetave publike do të ishte i dobishëm edhe thjesht për të na shtyrë të rishikojmë disa bindje, të përhapura te ne dhe të pambështetura në realitet.

Vizion

*Shpëtim Çuça, përkthyes dhe publicist. Titulli kryesor është "Mesazhet e Dritëro Agollit", (kujtimin për të). Shkrimi botohet enkas për "Milosao".
Tiranë, maj-gusht 2017

R

RRËFIME

NGA MERITA SHKUPI

Megjithëse ka kaluar pothuajse gjysmë shekulli disa episode absurde, të jetuara aty nga fillimi i viteve 70-të të shekullit të kaluar, të cilat rriteshin e bëheshin të mëdha e të frikshme duke u ngjizur nga hiçi, gdhenden në kujtesë me të gjitha hollësitë.

Ishte viti 1971, kohë kur dallga e ndikimit të 'Revolucionit të Madh Kulturor Kinez' kishte rënë disi në Shqipëri. PPSH lejonte ndjekjen e lajmeve të RAI-1 dhe RAI-2 që përforcoheshin nga antena e Dajtit. Radio Tirana transmetonte këngë të Engelberg Humperdinck-ut, Enrique Iglesias-it, apo Charles Aznavour-it. Në kampin e studentëve në Durrës dëgjohej muzikë 'dekadente' që nga mëngjesi deri në darkë. Më pat bërë shumë përshtypje djali i një ambasadori që dilte në krye të kampit dhe këndonte këngën e famshme të Little Richard-it 'Lucille', që ne e kujtojmë sipas theksimit të autorit si 'Lusia'. Ishte një këngë që përmbante nota të larta uluriltesë. E pata provuar edhe unë vetë ndonjëherë që ta përqasje por nuk arrija dot. Ishte koha kur Gux Bekteshi bërtiste nga një trotuar në tjetrin: 'Tezorooo! Ishte koha kur në Tiranë qarkullonte një thashethem se Lad Shehu kritikonte të atin për të gjitha krimet që kishin bërë baballarët komunistë. Ne mblidheshim e vrisnim mendjen së bashku për të zbrërthyer alegoritë e shprehura nga Kadare në veprat e tij. Ishte koha kur intelektualët filluan të guxonin.....'

Unë sapo kisha mbaruar provimet dhe vendosa të festoja me shoqen tim Didi. Lindita ishte emri i saj i vërtetë por ajo parapëlqente ta thërrisnin Didi, me emrin e një futbolli të famshëm brazilian të viteve 1950-60. Unë nuk isha tifozë por me Didin më lidhte diçka tjetër. Edhe ajo 'çmendje' pas muzikës moderne dhe kulturës përdimorë e shpesh më jepte të lexoja libra të ndaluar që ndonjëherë i kopjonte edhe me dorë.

Ato ditë në Tiranë kishin ardhur futbollistët e Kombëtares të Republikës Federale Gjermane dhe propozimi i Didi ishte që të dilnim në bulevard se mos shihnim ndonjë figurë interesante si për shembull Beckenbauer-in. Po çapiteshim nga trotuari i Parkut 'Rinia', përballë Hotel 'Dajtit' ndërkohë që përpara nesh po ecte një i huaj. Të huajt në atë kohë na dukeshin si 'alienë'. Kureshtja jonë për ta parë nga afër, për të këmbyer ndonjë fjalë me të ishte jashtëzakonisht e madhe dhe megjithëse kishim dëgjuar që po të flisje me ta përfundonjë në hetuesi, nuk iu shmangëm dot tundimit.

'How are you, how are you', bënim në sikur po flisnim me njëra-tjetrën dhe qeshnim, pa na shkuar aspak ndër mend se i hua-

rrëfimi lexohet këndshëm sepse përmban shumë elementë dokumentarë, që lidhen me autoren dhe kujtimin e një Tiranë që nuk do të kthehet më...



Shshshsttt.... erdhën!!!.....

ji mund të kthehej e të na përshëndeste. Dhe ashtu ndodhi. Në Shqipëri nuk qëllonte që t'i flisje tjetrit pa u prezantuar. Ne u kapëm mat kur i huaji u rrotullua me 180 gradë dhe duke buzëqeshur na pyeti: 'But you, how are you?' 'Ooo, good, good!' përsërisnim ne pasi nuk dinim çfarë të thoshim në vazhdim.

I huaji ishte austriak dhe quhej Rikard. Ai vetë, me sa dukej, po plaste të fliste me ndonjë shqiptar sepse të gjithë i zhdukeshin si me magji. Ne dinim fare pak anglisht në atë kohë por Rikardi për çudi dinte rusisht dhe kjo rrethanë na ndihmoi të merreshim vesh për bukurri. I treguam si qusheshim, çfarë shkollimi kishim dhe për çfarë studionim. Për të justifikuar sjelljen tonë disi të pazakontë i thamë që sapo kishim mbaruar provimin dhe i lejuam vetes një trill.

Vazhdimin normal të kësaj bisede të këndshme që arriti njëfarë kulmimi kur Rikardi na u drejtua ne me 'Hey, pretty girls.... (kompliment që s'para dëgjohej në atë kohë) na e prishi një haflje që qëndronte në cep të trotuarit dhe po na fiksonte. Me sa dukej përpigje të merrte vesh se çfarë flisnim. Edhe Rikardi e kishte vënë re pasi diçka kuptoi nga shqetësimi ynë dhe na propozoi të lëviznim në drejtim të Universitetit. Ne nisëm të nxitonim për të krijuar njëfarë largësie nga haflja, mirëpo ai shfaqej gjithnjë pranë nesh. Ne nuk dinim asgjë për Rikardin, as se kush ishte ai dhe si ndjehej në ato rrethana por dukej qartë që ai e kuptonte fare mirë situatën.

Me naivitetin tim të asaj kohe propozova të vraponim, por Rikardi na ndaloj duke na thënë se kjo nuk pinte ujë dhe për më tepër do të shtonte dyshimet. Propozoi të shkonim në një dyqan sepse donte të blinte një shishe konjak për 'ljekarstvo' (ilac, bar, në rusisht). Ai ndofta u ruajt se mos ne do të mendonim që ishte një pjanec prandaj shtoi se 'i dhimbte fyti dhe e donte konjakun për ilac'.

U kthëm në drejtim të qendrës duke u bërë pjesë e xhiros së famshme të asaj kohe që bllokonte bulevardin e Tiranës pas orës 6 të mbrëmjes. Njerëzit që na përshëndesnin e dallonin që ishim me një të huaj dhe ndonjeri pas përshëndetjes shtonte: 'hëëëë...'. Rikardi e kuptoi që i kishim krijuar vetes një problem dhe na pyeste herë pas here: 'çfarë tha, si është puna?' por ne e qetësonim atë, ndërkohë që ne të dyjave po na shtotej ankthi.

Papritmas përballë na doli vël-lai i Didi.

'Çështë ky?' - pyeti disi i nxe-hur.

'Kërkon një dyqan konjaku', e justifikuam ne shpejt e shpejt.

'Ikni në shtëpi se ia tregoj unë dyqanin', foli disi prerazi ai.

Ne të dyja u larguam nga xhi-roja por mbetëm edhe rreth dy orë bashkë duke kujtuar çdo hollësi, që nga veshja e deri të çdo fjalë e Rikardit duke shprehur habinë tonë se si i kuptonte të gjitha hiletë tona ai.

Vëllai i Didi që ishte teknik avionësh e shkolluar në BRSS, fliste rrjedhshëm rusisht. Bashkë me Rikardin pasi kishin blerë 'ljekarstvo'-n, ata kishin shkuar te Parku përballë hotel Dajtit dhe ia kishin shtruar me të pirë, madje disi çakërçeqif kishin kënduar edhe këngë ruse. Ndonësi Didi dhe vëllai i saj ishin me 'biografi të mirë' çështja 'Rikard' pas shumë peripecish me hetuesinë sollli largimin nga aviacioni të inxhinierit 'me ca lakra në kokë' siç thuhej atëherë duke i shpëtuar për fare pak burgut.

Pas dy-tri ditësh Didi erdhi në shtëpinë tonë fshehurazi nga prindërit pasi mamaja e saj ia kishitë ndaluar prerë të më takonte mua. Kjo për dy arsye: e para sepse unë isha bija e një, të shpronësuar, që në fund të fundit konsiderohej armik i pushtetit popullor dhe e dyta sepse e kisha futur në një tolovit të rrezikshme. Megjithatë ajo erdhi që të më paralajmëronte se po të më thërrisnin në hetuesi të mos tregoja asgjë për

çfarë folëm. Unë me timen thoja se nuk kishim pse fajësoheshim pasi nuk bëmë politikë por ajo këmbëngulte: 'Ne nuk thamë asgjë, e kupton? Ne nuk dimë të flasim. Kuptuam vetëm se ai kërkonte dyqan.' 'Mirë', u binda unë ndonëse nuk më mbushej aspak mendja për ta pranuar një logjikë të tillë.

Çdo orë që kalonte më vinin ndër mend historitë që kishim dëgjuar dhe si patën përfunduar disa nga shtresa jonë në të tilla raste. Sa herë që bëja ndonjë kurturisje nuk e çaja kokën për vete por për familjen që më kishte porositur me mijëra herë të kisha kujdes. Atyre nuk u thosha dot se në ç'ngatërresë isha futur. Rrija tërë kohën në shtëpi sepse më thoshte mendja që po të dukeshin rrugëve do t'u kujtohesha hafljeve që gelonin kudo. Haflja e mbyllja libra pa u përfunduar në pasazhet që lexoja. Megjithatë më mbeti i fiksuar në tru një pasazh nga 'Kronikë në gur' i Kadaresë ku fëmijët në një mëhallë të Gjirokastrës kishin dëgjuar nga të mëdhenjtë që armiqitë flisnin 'kundra'. Ata thoshin 'haide flasim kundra': 'Xhundra, bullundra; Llaftra, shallakaftra.' Po përpqesha me mend të gjeja një njeri që të ishte shumë 'kundra'. E gjeta, Alida. Më kundra se Alida nuk kishte si bëhej.

Vajta tek ajo që të zbrazesha. Kur ia tregova situatën, ajo ndërroi bisedë dhe vijoi me ca tema të tjera krejt pa rëndësi, sikur nuk kishte kuptuar asgjë nga ato që i kisha thënë. Kishte të drejtë. Shpesh ata që dëgjonin për akte të tilla 'tradhtie' si ai që kishim bërë unë me Didin dhe nuk denonconin dënosheshin njëllor si 'tradhtarët' e mirëfilltë.

U ktheva në shtëpi. Rashë të fle por nuk më zinte gjumi. Nuk mund ta mbaja më ankthin për-brenda dhe nga mesi i natës zgjo-va motrën time Moxhin dhe iu zbraza. Moxhi zakonisht nuk dilte por, nëse halli do të ishte i madh, ajo do të përpëliste sytë e askush nuk e merrte vesh se çfarë mendonte. Pasi palosi e shpalosi mbulesat për njëfarë kohe, mbas

pothuaj një ore foli me zë kumbues: 'Unë nesër do t'i dal përpara shokut Enver!'

Në atë kohë qarkullonin historitë sikur Enver Hoxha, si babaxhan që ishte, kishte falur jo pak njerëz të cilët u patën rrëshqitur rojeve të tij e ia kishin qarë hallin e tyre. Pas kësaj Moxhi fjeti.

Unë nuk mbaj mend nëse fjeta apo jo por me kalimin e kohës u binda që 'çështja' që mbyllur. Megjithëse e kisha gjithnjë të pranishme brenda meje ndiesinë se 'çështja' mund të hapej përsëri.

Ishta në një pritje të ankthshme. Rëndom më kujtoheshin episode që kishin përjetuar prindërit e mi në vitet 1946 - 1948. Ishin vite kur terrori kundër antikomunistëve kishte arritur kulmin. Çdo ditë pëshpërteshin emrat e atyre që arrestoheshin natën dhe përfundonin të pushkatuar pa gjyqe e pa fakte. E ngaqë ndodhte shpesh të pushkatoheshin njerëz që nuk kishin bërë gjë prej gjëje frika bëhej edhe më e madhe. Njerëzit që nuk i ngrohte fare regjimi i ri, dilnin nga puna e mblidheshin në shtëpi duke u përfunduar në dy drejtime: me njerin vesh ngjitur me aparatit e radios për të dëgjuar diçka sadopak shpeshdhenëse nga Radio Londra, dhe me veshin tjetër drejtuar nga rruga ku jo rrallë kalonin makinat e sigurimit (simbol i të cilave më vonë u bë GAZ-69) tërë frikë se mos trokiste dera e tyre.

Një ditë dimri - më rëfente im më - të atyre viteve, nga ora 6 e mbrëmjes u dëgjua në rrugë një makinë ushtarake që kishte ndaluar afërsisht para derës sonë. Të gjithë banorët e shtëpisë në atë kohë banonin shumë kushërinj tanë në shtëpinë tonë dolën nga dhomat e tyre dhe u mblodhën në korridorin e përbashkët duke parë njeri tjetrin në sy por pa folur. Kush do të arrestohej? Të gjithë e kishin nga një 'cen'. Ndofta makina do të largohej. Mirëpo zhurma e motorit të ndezur dëgjohej ende. Pas pak u dëgjua trokitja. Të gjithë kapërdimë pëshëm dhe secili po mendonte se duhet të ishte gati për 'gjemën'. Im atë që me pizhama, dhe mamaja me zërin e dridhur i thoshte: 'Ik, vishu Çimi...'. Kishte ndodhur shpesh që policët nuk i kishin lënë të visheshin viktimat e tyre, mirëpo Çimi nuk po lëvizte dot sikur i kishin ngrirë këmbët.

Guximin për ta hapur derën e mori burri i hallës sime, S. Borshi, të cilin i patën pushkatuar dy vëllezër. Kishte qenë në një qeli me ta. Por kryeqytetari qëllor të ishte një ish vartës i tij në ushtri që e njihje mirë se që antifashist. Për një rastësi të fatit e nxorën të pafajshëm.

Një oficer u shfaq në kornizën e derës së hapur dhe pyeti: 'A e dini ku e ka shtëpinë oficer Qerimi?'

'Sigurisht - ia pritë Sezaiu - portat përballë!'

Duke u përpjekur disi të përmbanin shqetësimin e thellë që ende nuk u ishte fashitur, me këmbët që u dridheshin, secili u kthye në kthinën e tij. Në shpirtin e tyre nuk gjente vend gëzimi i shpëtimit. Ata e dinin që ankthe të tjera do të vinin, të frikshëm, të ngjethshëm, të papritur. Dhe askush nuk e merrte dot me mend se deri kur do të hiqej zvarrë fati i tyre.....

L
LAJM

NGA BEHRIM JUSUFI

Diplomacia si art i politikës së jashtme të një shteti ndaj shteteve tjera, është rregulluese e raporteve, interesave të përgjithshme për mbarrëvajtjen e marrëdhënieve të shteteve në çdo sferë: politike, ekonomike, kulturore dhe të tjera. Themi art, ngase është mjeshtëri, të dish të paraqesësh pikëpamjet e veta, të promovosh kulturën, traditën, të menduarit dhe veprën në popujt, traditat e ngjashme, apo mund të kenë qenë këta dy popuj në hapësirat e njëjta në të cilat me shekuj kanë bashkëjetuar, edhe përpara se të kenë qenë kombe e shtete.

Po në anën tjetër, kemi menduar për një gjë më të bukur, për një diplomaci bashkëkohore më mbresëlënëse, diplomacia e letërsisë apo letërsia si diplomaci? Pasi

Diplomacia si art i politikës së jashtme të një shteti ndaj shteteve të tjera, është rregulluese e raporteve, interesave të përgjithshme për mbarrëvajtjen e marrëdhënieve të shteteve në çdo sferë: politike, ekonomike, kulturore dhe të tjera...

Letërsia si demokraci
bashkëkohore!

E në fund të fundit ç'është jeta pa dashuri,
pa respekt, mirëqenie e lumturi?

A thua, kulmi i lumturisë është të qenit paqedashës,
apo lakmitar për pushtet, monopol, pasurim e okupim?



ia e: shprehjes, lëvizjes, mendimit, komunikimit dhe veprimit. Një gjë e ngjashme pati ndodh pikërisht me 30.09.2017, në qytetin historik të Prizrenit, ku kjo frymë i bashkoi tri shtete dhe tri etni: Bosnjë dhe Hercegovinën, Shqipërinë dhe Kosovën, i tuboi shqiptarët, boshnjakët dhe turq në Qendrën Kulturore "Yunus Emre", në të cilën u mbajt promovimi i dy romaneve të akademikut Enes Kariazë: "Pjesme divjljhi ptica" dhe "Jevrejsko groblje" të përkthyer edhe në shqip "Këngët e zogjve të egër", me përkthim të dyfishtë njëri në Gjilan nga OJQ "Drita" në vitin 2010, me përkthyes dr. Xhabir Hamiti dhe Musli Imeri, dhe tjetri në Tiranë nga "Poeteka" në vitin 2015, përthru Ben

Elementet qenësore të një diplomacie letrare do të ishin: liri-

pektehoje: e kundërta dhe e ndryshmja, besimi, vepra, kultura, etnia, gjuha dhe mendimi i tjetrit dhe të ndryshmit.

që letërsia është një pjesë e artit si koncept gjithëpërfshirës nga njëra anë, dhe meqenëse edhe diplomacia si e tillë është art, atëherë këto dyja do të shkriheshin në një të vetme, në një art ku do të kulmonte: e mira, lirika, poezia dhe proza. Do të përktheheshin veprat e autorëve të ndryshëm, në secilën gjuhë të mundshme. Prej kësaj do të kishin leverdi sidomos: etnitë, popujt, kombet dhe shtetet të cilat i përafrojnë shumë elemente: historia, kultura, tradita dhe hapësira gjeografike.

Përkthimi, leximi, e promovimi i veprave që do të shërbente si filozofi e re e të menduarit të popujve të caktuar të cilët mbillnin urrejte në historinë e tyre shumëshekullore, kishin përçarje dhe një të kaluar të hidhur, sikurse është rasti me ballkanas. Kjo diplomaci do të ishte shkëndijë e ndryshimit të vetdijës, së po atyre popujve, shkak për një të nesërme më të mirë, zbutje të tensioneve, dhe fillimi i një etape ku do të res-

Kjo është një copëz nga romani i fundit i autores së njohur kroate, që është përkthyer në shqip dhe botuar nga "Poeteka". Kemi zgjedhur titullin "Fëmijët e dashurisë dhe urrëjtjes", që i shkon më shumë fabulës së këtij romani...

R
ROMAN

NGA DASA DRNDIĆ*

Edhe një i vetëm çast mjafton t'i celë të fshhejtat e jetës por celësi i vetëm i të gjitha të panjohura është Historia, kjo përsëritje e përtjetshme dhe ky emër i tërheqës i tmerrit

Jorge Luis Borges

Prej gjashtëdhjetë e dy vjetësh pret.

Ajo ulet pranë dritares së lartë në dhomën e katit të tretë të një ndërtese austro-hungareze, në pjesën e vjetër të Gorizias së Vjetër dhe përkundet aty. Karrigia është e vjetër dhe gërvin teksa ajo lëkundet.

Po gërvin karrigia apo mos po rënkoi unë? pyet ajo zbrazëtinë e thellë, që si çdo zbrazëti, e shtrin kudo mantelin e saj të madh të mos e përthithë lëkundjen e gruas, ta gëlltisë atë, të mund ta mbulojë, fundosë, mbështjellë, duke e gatiur për groposje në të cilën kjo boshësi, boshësia e saj, është duke grumbulluar tani kufomat e ngrira të së shkuarës. Ajo ulet para dritares të saj së vjetër të errësuar, duke marrë frymë thellë dhe shpe-

jt (sikur të jetë duke ofsharë, por që në fakt nuk po e bën) dhe fillimisht orvatet të heqë qafe atë erë bajate përreth vetes, duke tundur duart sikur po heq qafe mizat, pastaj vazhdon në fytyrën e vet, sikur të jetë duke u larë apo po heq kleçkat prej qerpikëve. Kjo frymë e fëlliqtë (i kujt? i kujt?) e mbush dhomën, shndërruar në një rrëke inati dhe ai di se mund t'i sajojë guralecët rreth gurvarrit të vet, tani, për çdo rast, nëse ai nuk mund të vijë, apo për rastin kur vjen, pasi ajo për gjashtëdhjetë e dy vjet rresht po pret.

Do të vijë.

Ai do të vijë.

Ajo dëgjon zëra edhe pse zëra nuk ka. Zërat e saj kanë vdekur. Njësoj, ajo bashkëbisedon me këta zëra të të vdekurve, ngatërrohet me këta shpirttra, ngandonjëherë lëshohet dobët në krahët e tyre, kurse ata i pëshpëritin dhe e drejtojnë kah peizazheve, të cilat i ka harruar. Në kokën e saj ngjarjet ndodh të gëlojnë dhe atëherë mendimet i shndërrohen në udhë statuetash, granitësh, mermeri, guri, figurinash gipsi, të cilat vetëm sa lëvizin buzët dhe përpëlitën. Duhet të mbahen. Pa zërat, ajo është e vetme, kapur në kafkën e vet që shkon e bëhet me e butë, më e prekshme mu si kaffa e një të sapolliduri, në të cilën truri nga pak mumifikohet, pulson i lodhur në lëngjet e vrerëta, ngadalë, si zemra e saj, e pos të gjithave çdo gjë zvogëlohet. Dhe sytë e saj janë të vegjël e me lot. Ajo i fton zërat që nuk ekzistojnë, zërat të cilët e kanë lënë, i fton për t'ia plotësuar brak-

Sonnenschein

tisjen.

Tek këmbët e saj gjendet një kosh i madh i kuq që i mbërrin deri te gjunjët. Prej koshit ajo nxjerr jetën e saj dhe e var mu në një konop imagjinari realiteti. Heq letra, syresh gati njëqind vjet të vjetra, fotografi, kartolina, pjesëza gazete, revista dhe shifleton mes tyre, shleton përmes grumbullit të letrave pa jetë dhe atëherë i rigrumbullon sërish, këtë radhë mbi dysheme, apo mbi tavolinën pranë dritares. Rregullon ekzistencën e saj. Mishëron prejardhjen e vet, fatin e vet, besimin e vet, qytete dhe fshatrat në të cilat jetoi kohën e vet, kohën e grumbulluar dhe të denatur, të ngjashme me një kuçak gjigand që mjeshtrohet e kuzhinës në tregjet e qyteteve të vogla të Mitteleuropa e përgatisin për festat popullore dhe atëherë ajo e merr atë, e gëlltit dhe e grumbullon të gjithën, e bllokton vetveten brenda saj, dhe e gjitha ajo tani kalbet dhe dekompozohet brenda saj.

Ajo është tmerrësisht e qetë. Dëgjon predikimin për veshët e palarë dhe e shtrin vetveten në historitë e të tjerëve, këtu në dhomën e stërmathe brenda banesës së vjetër në Via Aprica me numër 47 në Goricë, që italianët e quajnë Gorizia, në gjermanisht njihet Görz kurse në dialektin friulan Gorizice, një miniaturë kozmose në këmbët e Alpeve, ku brigjet e lumit Isonzo apo Soëa, i bashkohet lumit Vipave në kufijtë e perandorive të rena.

Tregimi i saj është një rrëfim i vogël, një nga ato të panumërtit syresh për takimet, për gjurmët e ruajtura të kontakteve njerëzore, ajo këtë e di, ashtu si di që toka mund të fletë deri sa të gjitha historitë e botës të rregullohen në kozmikën e gjerë të patchëork-ut, që do mbështjellë Tokën, e deri atëherë historia, fantoma e realitetit, do të vazhdojë të shthurë, të presë, të ndajë çikazi, të kapë copëzat e hapësirës dhe t'i qepë në mbulesën e vetë vdekjes së saj. Ajo e di se pa rrëfimin e saj, historia do mbetet e pakryer, ashtu si e di që atje s'ka fund në të vërtetë, që fundi shkon drejt hapësirës së përfundimit, përtej ekzistencës. Ajo e di se fundi është çmenduri, ashtu si i pati thënë Umberto Saba dikur, ndërsa dergjej këtu në Gorizia, mbase ishte me rrobën e doktor Basaglias apo ndoshta ishte në Trieste tek doktori Eëis, ajo e di se fundi është një ëndërr nga e cila nuk zgjohesh. Dhe shkurtesat që ajo merr, udhët më të afërta për të shkruar prej një vendi në tjetrin, ngandonjëherë janë të pakalueshme, janë realisht shtigje dhish. Këto shkurtesa mund të trajtojnë nostalgjinë e vet për ato udhë të gjata, të drejta, drejtëzore, udhë provinciale, për të cilat gjithashtu Umberto Saba i pati treguar diçka atëherë, ndaj ajo i fshin gëmoshat e kujtesës së vet, kujtime për të cilat ajo nuk mund të thotë nëse ato janë mbytur gati në kujtime apo janë ende në të tashmen,

Andoni. Kurse romani "Varrezat çifite" u përkthye në Shkup nga "Logos A" në vitin 2016, përktheu Agim Leka.

Atmosfera nga ky promovim ishte jashtëzakonisht mbresëlënëse, madhështore. Pikëpamjet të cilat i paraqitën promotorët e këtyre romaneve ishin koncepte të njëjta të thëna me fjalë të ndryshme, që të tre promotorët i bashkoi e njëjta frymë, i njëjti mesazh e njëjta dëshirë që bartnin romanet e akademikut Kariazë. Ben Andoni si përkthyes, mr. Azmir Jusufi si teolog dhe dr. Sadik Idrizi si publicist, shrydhën gjithë përmbajtjen e romaneve, ajkën dhe margaritarë të tyre dhe shkëlqenin gjatë paraqitjeve të tyre.

Shpresojmë që gjërat të tilla të ndodhin sa më shpesh, derisa të arrihet ideja e diplomacisë letrare mes ballkanaseve, por edhe popujve në gjithë globin. Vetëm ashtu rrinia do të ketë mundësi të takohet, të shkëmbejë ide e mendime, t'i përafrojë pikëpamjet dhe të respektojë të kundërtën dhe të ndryshmen. Një jetë ku do të respektohen vlerat individuale dhe kolektive, etnitë, besimet, kulturat, gjuhët, bindjet, dhe pikëpamjet. Ku vepra e individit do t'i shërbejë shoqërisë për progres, ku njerëzit do të respektohen dhe do të jetojnë në paqe e dhe do mundohen për ideale të madhështore për mbarë njerëzimin.

diku mënjatë, të ruajtura, të palosura. Përgjatë këtyre shkurtesave të stërmathe ajo çapitet. Ajo e di se nuk ekzistojnë rastësi; se nuk janë si ajo tulla e famshme që bie mbi kokën e ndonjë njeriu; ekzistojnë marrëdhënie-dhe vetëvendosje-prej të cilave me sa duket s'jeni në dijeni, për të cilat ne kërkojmë.

Ajo ulet dhe përkundet, qetësisë e saj është e padurueshme.

Është e hënë 3 korrik 2006

HURRY UP PLEASE IT'S TIME

Quhet Haya Tedeschi. Është e lindur më 9 shkurt të vitit 1923 në Gorizia. Në dokumente shkruhet se më 8 prill në të njëjtin vit 1923 u pagëzua nga prifti Aldo Boschini, që natyrisht ajo nuk e kujton, ashtu si nuk i vjen ndërmend as nuna e vet Margherita Collenz. Pagëzimin e ka dëruar Don Carlo Baubela. Baubela është biemër gjerman. Don Carlo Baubela-n ajo e takon në vjeshtën e 1944 kur ai është i mosuar, i kërrusur dhe shpërhap kundërmimin e temjanit dhe duhanit me duart e tij gjysmë të ngrira dhe që i dridhen kur i jep bekimin. Gorizia është një qytetë e vogël e këndshme. Në Gorizia kanë ndodhur histori interesante, histori të vogla familjare si kjo e saj. Shumë anëtarë të familjes ajo nuk i njohu kurrë. Për shumë syresh as nuk kish dëgjuar. Prindërit e nënës së saj dhe prindërit e të atit kishin familje të mëdha. Ka dhe kish pasur familje në Gorizia me histori të koklavitura, por historitë e tyre nuk kishin rëndësi përveç mënyrës që his-



Vijon në faqen 20

P

POEZIA

Një poezi e veçantë gjithnjë në ngjiturje

NGA BARDHYL AGASI

Kushdo që është njohur me krijimtarinë poetike të Petraq Ristos, mund të ketë pyetur si është e mundur që për vlerat dhe zërin e saj të veçantë të mos jetë bërë objekt i një studimi të gjerë, që sigurisht do të evidentonte një ecje të suksesshme të poezisë shqipe në këto tri dekada, duke ndjerë, gjithashtu, nevojën e një kritike letrare profesioniste, e cila potohuaj ka munguar gjatë kësaj periudhe të tranzicionit. Nuk mund të mendohet se ky shkrim do të plotësonte sadopak këtë boshllëk, por nisem të jap një mendim modest pas botimit të librit të tij të fundit me titull "Para-j-sa?!". Është folur se letërsia jonë, pra, edhe poezia, nuk po nje nivele të tilla si në vitet 60-të dhe 70-të e më tej të shekullit të kaluar, duke iu referuar autorëve dhe veprave të atyre viteve. Mendoj se nuk duhet mbetur në këto vlerësime dhe gjykime, mbasi, pa asnjë ndrojtje, mund të shprehem se sot ka autorë dhe vepra të cilat shënojnë arritje të ndjeshme të letërsisë sonë dhe veçanërisht poezisë. Pavarësisht nga vështirësitë e kohës, poetë të shumtë kanë gjetur mundësi të botojnë dhe po t'i marrësh në sasi përbëjnë një shifer të konsiderueshme. Mes tyre, ndjen zëra të fuqishëm poetike, që padyshim i japin një përfaqësim të denjë poezie shqipe dhe në arenën ndërkombëtare. Nder poetët e ditëve tona të një krijimtarie me përmasa të mëdha, ndër më të njohurit dhe më të afirmuarit është Petraq Risto, poezia e të cilit i ka kaluar tanimë kufijtë e tokës mëmë. Ajo ka marrë fluturim lartësive, duke i dhënë ajrit gjithë kodet dhe mesazhet e shpirtit të tij. Vetë titujt e librave të tij të shumtë poetikë, krahas atyre në prozë, janë kode që duhen zbërthyer për të kuptuar domethënien e tyre dhe për të zbuluar thesaret poetike

Shënime për vëllimin e ri poetik të Petraq Ristos "Para-j-sa?!"

gjatë shfletimit nga fillimi deri në fund. Vëllimi i botuar sëfundmi titulluar "Para-j-sa?!", është një lartësi tjetër e ngjitjes së Ristos, ashtu siç është shprehur dhe prof. Alfred Uçi: "PRisto është ndër ata pak emra poetësh që u afrohet majave".

Risto është një poet që guxon, ai nuk rreket në trajtimin e një tematike të ngushtë. Dhe atëherë kur vështrimi i tij poetik ngulitet në një gjë në dukje e rëndomtë, ai i jep asaj dritë, e gjallon dhe e larton me një kuptim simbolik. Poezia e tij s'ka limite kohorë, e shkuara, e tanishmeja dhe e ardhmja shkrihen mes tyre, duke zbuluar ide që i përkasin çdo realiteti dhe që i shërbejnë aktualitetit pa kufij gjeografikë. Si e tillë ajo ka karakter universal dhe pavarësisht nga vendi ku është shkruar, në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, në Brunch Brook Park në New Jersey, në libraritë Barnes & Noble në New York, apo në Ankona të Italisë, etj., çdo lexues i kudo ndodhur ai, e ndjen atë si të mbirë në dheun e tij. Idetë dhe tematika e poezisë së Ristos janë të përgjithshme, të ndjeshme në realitetin e çdo vendi në këtë epokë globale dhe si e tillë ajo ka fituar të drejtën e qytetarisë dhe të nënshtetësisë kudo ajo shfaqet dhe merr udhë. Por ajo, siç është vënë në dukje, para së gjithash është shqiptare, në çdo varg të saj ndjehet aroma e dheut shqiptar, ajri i saj, shpirti dhe gjaku shqiptar.

Çdo mëngjes në Amerikë pi një gotë raki shqiptare, në qiellzë zjohet hardhia e kopshtit tim....

Poezia e Petraq Ristos është gjithmonë në shtetgim, jo thjeshtë një letër e shkruar dhe e palosur brenda një çante, por gjithmonë si një dritare, e që mbarë me vete dhe



i gjen një mur kudo që ai vendoset.

Në vend të çantës në krah kam një dritare: po shkoj ti gjej një mur....

Dhe poeti nga ajo dritare lëshon tufat e vargjeve të tij, herë vetëtimar rrefesh, herë me flatra shqiponjash, herë me petale trëndafilash. Poezia e Ristos ngrihet në revoltë, kumbon si një thirrje, bëhet sirenë alarmi për rrezikun që kanos botën tonë, bashkohet me dhimbjen për njerimin dhe varfërinë, psherëtim zhgënjimor për ëndrrat e shuara, ndjen neverinë për botën dhe heshin mizore, për atë shoqëri, ku pyetja e parë që bëhet është: Sa para ke? Madje, me guximin e një poeti qytetar, ai zbulon të vërtetën ku paraja bën ligjin edhe në një vend të tillë si Amerika, shembulli i Demokracisë dhe progresit.

Las Vegas: karusel Para-je
Las Vegas: karusel ku Ferri vlon
mbi Para-j-së
Paral...Paral...Paral...Sa?...Sa?...Sa?...

Apo ku

Statuja e Lirisë pyet: Ç'do të

thotë Liri?

Një nga poezitë më të bukura të vëllimit është "Muri dhe fluturat Monark", ku poeti shpreh me tone revolte kundër ngritjes së mureve të rinj, tani pas gati tri dekadash nga rënia e Murit të Berlinit.

"Dhe (mbi gjithçka) kam një merak: Do i pengojë Muri fluturat Monark?!"

Poeti është i shqetësuar për problemet aktuale si lufta kundër terrorizmit, kundër armatimit dhe garës bërthamore, kundër korrupsionit, drogës, prostitucionit si plagë kryesore të shoqërisë së sotme globale, ku s'ka heronj, por është koha heroinës dhe kokainës, që vret shpirtat e rinisë kudo. Një thirrje të Ajnshtajnit për ndalimin e armës bërthamore, poeti e bën apel të tij në poezinë "Anshajtini i shkruan presidentit", duke i dhënë një tingëllim aq të fuqishëm aktual. Apeli i Ristos sjell në kujtesë luftrat e mëparshme botërore, ku miliona të vrarë të planetit duhet të ktheheshin në përvojë. Me kurajon e një poeti të madh, Risto u drejtohet popujve që të shohin në sy të vërtetën dhe të mos i tremben asaj si kualet kamxhikut, të mos lejojnë që planeti të jetë "nën një këmishë hekuri..."

I ndërgjegjshëm dhe vlerësues për rolin e tij si poet, Risto shpreh se një poet i vërtetë futet në kafazin e krahërorit të kohës së vet dhe bëhet ose zemër, ose mushkëri klithese dhe si e tillë poezia e tij rreh me pulsin dhe thith ajrin e kohës. Poeti jeton me kohën, vështrimi tij depërton deri në kthinat e saj, ai mbledh material të bollshëm jetësor, seleksionon duke na dhënë me esencialen, asaj që përbën thel-

bin më problematik të epokës.

Poeti, krahas problemeve të mëdha kohore, në poezinë e tij rrok dhe ato më të zakonshme, jetësore, njerëzore, të jetës së përditshme. Një lirizëm i hollë, i këndshëm përshkon gjithë poezitë për dashurinë, ku ndeshim "një grua prej shiu e sapoavulluar nga gjoksi i një burri", apo ku "njeriu dashuron shumë herë si lulëzimi në të njëjtat rrënjë"...

Në këtë vëllim me një titull sinjifikativ, si në të gjithë poezinë e Ristos përdoret një fjalor mjaft i pasur poetik, që buron nga e folura e përditshme popullore, por që merr një tingëllim dhe një ngjyrim të bukur, duke formuar vargje, që ngajnë me tufat e zogjve në fluturim, të rradhitura me një strukturim të mrekullueshëm arkitektonor. Jeta dhe natyra, lulet, pemët, gjetohet, zogjtë, dielli, hëna, qielli, ajri, yjet, ylberi, era, vetëtimja, shiu, zemra, gjaku dhe shpirti i njeriut etj., përdoren me mjeshturi në botën e tij metaforike dhe alegorike. Metaforat e Ristos të shpërthyer nga një fantazi krijuese larg abstraksioneve të pakapshme, perceptohen këndshëm dhe nga një lexues i thjeshtë; poezia e tij është sa elitare aq dhe e përthithur nga kushdo.

Poezia e Petraq Ristos është e veçantë në formë dhe në përmbajtje. Vargu që ai përdor është i gjatë, ilirizëm, i rrjedhshëm, plot rimë dhe muzikalitet. Është thënë se një poezi e bukur është ajo që recitohet bukur. Lexuesi poezinë e Ristos e shijon më mirë nëse edhe ai vetë e shqoqron atë me recitim. Ndoshta vetë autori e reciton më parë dhe e shkruan, ose e shkruan duke e recituar, duke ndjerë gurullimin e ëmbël të një lumi që rrjedh drejt detit të tij poetik.

Vazhdon të debatohet ende për raportin mes poezisë së traditës dhe asaj moderne, duke e parë të parën si të vjetëruar dhe të konsumuar, si dhe të dytën si poezi të kohës. Madje, tani flitet dhe për poezinë postmoderne dhe nuk dihet se kur do të kemi dhe poezi postmoderne. Në emër të kësaj të fundit ndeshim edhe poezi, sidomos në rrjetet sociale, që veç autori mund të dijë se ç'ka dashur të thotë. Poezia e vërtetë s'ka nevojë për mbiemra pas saj. Ajo dallohet nga ideja që mbarë, nga përmbajtja, nga ndjenja e fuqishme që i përçon lexuesit, nga shija estetike që i ndjell dhe, si e tillë, ajo është moderne. Në këtë kuptim poezia e Ristos është moderne, e kohës dhe e përvetësueshme nga të gjithë. Nuk dua ta fus poezinë e tij në shtretërr rrymash, ekzistencialiste, moderniste, impresioniste, abstraksioniste etj., etj. Ajo është para së gjithash një poezi realiste, që dritëzohet nga një romantizëm bashkëkohor, një poezi e kohës dhe për kohën, një poezi që u drejtohet të gjithëve dhe u përket të gjithëve, me vështrim nga e ardhmja për të gjithë. Dhe pse për vlerat e saj janë shprehur poetë dhe kritikë të shquar brenda dhe jashtë vendit, unë dua të përsëris se poezia e Ristos, si krejt e veçantë dhe për origjinalitetin e saj, për idetë e fuqishme që shpallon dhe për nivelin e lartë artistik meriton me shumë vëmendje dhe të bëhet objekt studimi jo vetëm nga kritika, por dhe në auditoret dhe tekste tona shkollore, për t'u dhënë edhe më freski atyre, sepse siç ka vënë në dukje edhe shkriktari dhe poeti ynë i shquar, Moikom Zeqo: "Petraq Risto është një talent i vërtetë dhe e pasuron poezinë shqipe jo me retorikë, por me substancë të re"

→ Vizion nga faqja 19

toria i kish zvarritur ata përgjatë shekujve, ashtu si pragjet e lumit përfshijnë degët e thyera lënë të lira aty në brigje dhe kërmat e bagëtisë, me barqet e fryra, lopët, sytë e tyre të tejkushëm, minjtë e pabishtë, kufomat me fytyrë dhe therura dhe vetëvrasjet. Në familjen e saj nuk kishte pasur të vetëvrasë. Edhe nëse ata do të kishin qenë, asaj nuk i kishin thënë ndonjëherë asgjë.

Në Gorizia bënë vetëvrasje disa personazhe të njohur. Përmes Gorizias kaluan shumë, disa mbetën, disa ikën. Mes tyre kishte Hebrjen dhe Paganë. Prej tyre kishte poetë, filozofë dhe piktorë. Burra dhe gra. Njeriu më i njohur që ka vrarë veten në Gorizia ishte Carlo Michelstaedter.

Nëna e saj quhej Ada Baar... Shumë vite u deshën të mblidhte të dhëna nga të cilat sajoi pemën e klovlarit të familjes së saj dhe mësoi se cili ishte, dhe i kujt syresh. Prej kohësh nuk ka

Sonnenschein

më se kë të pyesë. Ata që mbetën janë fare të pakta, dhe kujtimet e tyre janë të njollosura, plot me të cara mbuluar me vula të zeza harrese apo pretendimesh dhe ashtu si ishullat gëlltitur në flakët e mëdha ato ndriçojnë, bishnuet. Dhe zërat e vdekur të paraardhësve të tyre fërgëllojnë, rënkojnë, burrojnë nga cepat e dhomës, nga dyshemeja, tavani, kacavirren përmes grilave veneciane dhe e gërvishin historinë përtej shtripit të saj.

Ajo as nuk e dinte sesi dukeshin paraardhësit e saj. Nuk kishte prova. Nuk kish të dhëna.

Familja e saj trazohet në thellësi të tabanit (kujtesës së saj). Sot gjymtyrët, farefisi i afërt, janë kaq të ngatërruar, e aq të çrregullt, saqë është e pamundur të dish ku shtrihen. Organet e familjes së saj janë të shpërndara kudo. Por, jetët

e fisit të saj janë gjithnjë e më pak të dobishme për rrefimin dhe pritjen e saj.

Gjyshi i saj u lind në Görz. Nëna e saj u lind në Görz. Ajo lindi në Gorizia/Gorica. Kur shpërtheu Lufta e Madhe, fillori të lëvizte e të jetonte kudo. Ajo nuk e di sesi ishte Görz dhe nuk e di as sesi është Gorizia edhe pse ka plot gjash-tëdhjetë vjet këtu. Ajo i përshkon rrugëzat e Gorizias, por këto janë shtëpitë të shkurtra, shtëpitë të shpejta, shtëpitë me qëllim, këto janë bjerraditë. Edhe kur shtëpitja e saj është më e gjatë, apo kur shtëpitja e saj është më e ngushtë (që ndodh kur ditët janë të buta dhe dhoma e saj ndihet e ngrirë, një lloj inercie e lagësht), Haya në rrethinat e veta nuk vëren ndryshime të mëdha. Asaj i duket sikur në këto gjash-tëdhjetë vjet është e ulur në një dhomë të tkurrur, një

dhomë muret e së cilës zhvendosen ngadalë nga brenda të bashkohen me një sipërfaqe në miniaturë, një vijë, në kulmin e të cilës ulet, prehet. Ajo nuk e shikon, nuk e këqyr, e me copat e dylitit në veshë, nuk dëgjon. Görz, Gorizia këto janë ndijime. Nuk është e sigurt nëse kujtimet janë të sajat apo të familjes së saj. Ndoshta janë kujtime të freskëta. Dhe kur del, shullëhet në diell, mbledh Margarita, ulet në kafe "Joy" dhe tymos. Nuk e lë veten pas dore, nuk mban t'zeza, nuk lëkundet paprerë. E gjitha është mu si duhet. Ka një televizor. Ka disa kujtime, kujtime të vrullshme, të fragmentuara. Ajo tundet mbi fijet e të shkuarës. Mbi fijet e historisë. Ajo pwrkundet në një rrjetë merimange. Është shumë e lehtë. Rrëth saj, tani është mjaftueshëm qetësi. Gorizia ka histori, ajo ka histori. Ditët janë kaq të vjetra.

Ngandonjëherë ëndërron.

***Përktheu nga origjinali Ben Andoni**

Opinion *i* Ditës

Spanja nuk është Serbi e as Katalonja nuk është Kosovë!

Nga Arian Galdini

(vijon nga faqja 1)

... por pa diskutim që janë treguesit bazikë të cilit krah a kamp i përket në ndarjet e mëdha globale.

Që ne shqiptarët i përkasim Perëndimit dhe duhet të jemi për Perëndimin, me Perëndimin, në Perëndim, kjo nuk do shumë analiza e fjalë të gjata për ta pohuar, pranuar e kuptuar të gjithë.

Kush ngre dyshime a beson në të tjera alternativa e mundësi, nuk besoj se ka mësuar nga historia e ka rrokur saktë se cila është e mira natyrale e shqiptarëve dhe shqiptarisë si bashkëkuptimësi.

Të vijmë të zhvillimet më të fundit në Katalonjë.

Mediat i dhanë dritë pa fund, gjithçkaje që ndodhi me votimin për Pavarësinë e Katalonjës dhe dhunën policore mbi votuesit.

Vini re: në të njëjtën periudhë kohore diku në një anë tjetër të globit, kurdët kryenin referendumin e tyre për pavarësi.

Nuk mund të jenë të rastësishme këto dy ngjarje të mëdha historike që ngjizën, ngërthejnë e përzijnë shumë interesa e komplikime ndërkombëtare.

Madje vetë Presidenti i Turqisë, i kaq shumë adhuruar në Shqipëri, Kosovë e te shqiptarët e Maqedonisë, duke reaguar ndaj referendumit kurd, riktheu për diskutim shtetësinë e Kosovës.

Qarqe e media të caktuara, në Tiranë, Athinë a Beograd, nisen të përmendin skenarë të ngjashëm me atë të Katalonjës, në Himarë dhe Dropull.

Katalonja çuditërisht u barazua si rast me Kosovën dhe dhuna policore e qeverisë spanjolle mbi votuesit katalonjas, u krahasua me dhunën e mirëkuptueshme tashmë sipas tyre, të Millosheviçit.

Ta ndajmë këtë punë me kujdes. Serbia nuk është as Spanja e as ish-Jugosllavia. Serbia është një shtet i krijuar e njohur me marrëveshje ndërkombëtare pas rënies së Jugosllavisë, e pas ndarjes së Malit të Zi kur shpalli Pavarësinë.

Serbia është vend shkaktar, nxitës dhe fajtor për luftën dhe krimet e luftës që ndodhën gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Serbia ka qenë vend diktatorial gjatë regjimit komunist në Jugosllavi.

Serbia ishte vend diktatorial dhe luftëbërës e gjenocidkryes gjatë periudhës së prishjes së Jugosllavisë.

Serbia është ende një vend në zhvillim dhe me parametra dhe tregues të ulët demokratikë, në proces negociimi për anëtarësim në BE.

Ndërsa Spanja ka dekada që i ka mbyllur hesapet me diktaturat. Spanja është demokraci e zhvilluar dhe vend anëtar i BE-së.

Historia e Spanjës me Katalon-



Serbia nuk është as Spanja e as ish-Jugosllavia.

Serbia është një shtet i krijuar e njohur me marrëveshje ndërkombëtare pas rënies së Jugosllavisë, e pas ndarjes së Malit të Zi kur shpalli Pavarësinë.

jën mund të jetë si historia e çdo Landi të Gjermanisë me Gjermaninë.

Dhuna policore në një vend demokratik edhe kur është disproporcionale dhe harbute, si ajo që u ushtrua kundër votuesve për Pavarësinë e Katalonjës, është pa diskutim shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, është energjikisht e dënueshme, por kurrsesi e krahasueshme me aparatën kriminal të një shteti diktatorial.

Pse duhet të merremi ne shqiptarët me këtë çështje? Sepse në çdo fillimtor bota perëndimore feston bashkimin e Gjermanive.

Koha e ndarjeve mori fund me rënien e Murit të Berlinit.

U desh një luftë botërore makabre sikurse ishte L2B që bota të

ndahej më dysh pas përfundimit të saj. Gjysma e botës ra nën kthetrat e 'perandorisë së djallit' apo Bashkimit Sovjetik, dhe gjysma tjetër qëndroi nën Perëndimin e lirisë dhe vlerave e dinjitetit njerëzor.

Mbyllja paqësore e Luftës së Ftohtë, i dha menjëherë efektet e saj pozitive.

Lufta dhe dhuna ndajnë. Paqja dhe liria bashkojnë.

Bashkimi i Gjermanisë ishte edhe fitorja më e madhe e Perëndimit, ngase ky vend madhështor u bë edhe garanti i ëndrrës europiane.

Diktatura, lufta dhe dhuna e ndau e prishi edhe Jugosllavinë.

Në Perëndim është kohë paqeje dhe lirie, e nuk ka as vend e as kohë për ndarje.

Kush financon dhe mbështet

Dhuna policore në një vend demokratik edhe kur është disproporcionale dhe harbute, si ajo që u ushtrua kundër votuesve për Pavarësinë e Katalonjës, është pa diskutim shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, është energjikisht e dënueshme, por kurrsesi e krahasueshme me aparatën kriminal të një shteti diktatorial.

ndarjet brenda vendeve të lira, ka interesa lufte dhe tinëzare.

Terrorizmi i IRA-s dikur në Irlandën e Veriut dhe i ETA-s në Spanjë, është e ditur, provuar dhe e qartë nga të gjithë se ka qenë i financuar dhe mbështetur nga 'perandoria e djallit'.

Kthimi i IRA-s në OJF dhe qetësimi i ETA-s ka qenë fitore e Perëndimit, por jo përfundimtare.

Tashmë betejat dhe luftërat janë jokonvencionale. Ato zhvillohen në shtëpitë tona, në lagjet tona, në qytetet tona, me mjetet e lirisë dhe demokracisë.

Kësisoj, bëjmë mirë të jemi të kujdesshëm kur anësohemi e bëhemi palë me katalonjasit.

Ka një dallim themelitar që duhet ta bëjmë.

Qytetaria, rezistenca, fisnikëria dhe idealizmi i qytetarëve votues për Katalonjën, le të na bëhet model veprimi qytetar që na vjen nga Perëndimi.

Kauza e tyre nuk na përket neve e nuk është fare e mbështetshme.

Dhuna policore mbi qytetarët katalonjas është fortësisht e dënueshme.

Akti i mbrojtjes së integritetit shtetëror të Spanjës, meriton mbështetje pa ngurrim fare.

Spanja është vend lirie dhe demokracie. Mbrojtja e Spanjës është jetike për Perëndimin.

Kështu e mendoj dhe gjykoj unë, e shpresoj që qëllimin e këtij reflektimi ta përtypin, pranojnë dhe mirëkuptojnë sa më shumë shqiptarë.

Dua më shumë Shqipërinë!

HOROSKOPI

DASHI

Në dashuri kohët e fundit po bëni një hap prapa dhe një përpara. Merrni parasysh një kritikë konstruktive dhe do të kuptoni atë që dëshironi me të vërtetë. Pranoni ftesën e një miku që keni kohë që e njihni, i cili do t'ju ndihmojë t'i jepni zgjidhje një problemi të komplikuar.

DEMI

Falë Hënës në qielin tuaj që u buzëqesh Plutoni, Marsit dhe Venusit, do jeni shumë efikasë për të zgjidhur çdo çështje, shpejt dhe pa mundim. Do merrni shumë lavdërime, pasi do dini të vlerësoni iniciativat shumë mirë, pa iluzionet e tepërta entuziaste.

BINJAKET

Mund të gjendeni përpara dy personave shumë të rëndësishëm për ju. Të ndërmerrni rrugën e vjetër mund të duket zgjedhja më e mençur, por jo gjithmonë rezultoni suksesshëm. Për shkak të Saturnit kundër nga shenja e Shigjetarit, mund ta shihni të kufizuar lirinë tuaj të veprimit.

GAFORJA

Hëna favorizuese nga Demi ju sugjeron që të mos ngacmoni kujtimet e së shkuarës dhe të shijoni bukurinë dhe gëzimin që ju ofron e tashmja. Mos merrni rrezikun e panevojshëm të merreni me shumë gjëra njëkohësisht. Reflektoni mirë dhe zgjidhni prioritetet.

LUANI

Hëna të Demi do t'ju bëjë të pavendosur për shumë çështje, si në aspektin familjar ashtu edhe në atë sentimental. Shkëputuni pak dhe do e shihni që çdo gjë do shkojë në vendin e duhur. Me Jupterin bashkëpunues nga Peshorja, do dini të përfitonit më të mirën nga situatat e favorshme.

VIRGJERESHA

Hëna dashamirëse nga qielli i Demit do ju lejojë të dilni nga një kontekst i paqartë për të ndjekur një rrugë më të pëlqyeshme për ju. Venusit ju do të bukurojë dhe të ndritshëm; gjeni kohën për trajtime rigjeneruese dhe një model të ri flokësh.

PESHORJA

Me Diellin dhe Mërkurin që bashkohen në shenjë, sot nxitoni të mbyllni aktivitetet rutinë, por me mbylljen të të zgjeroni fushat tuaja të interesit. Ndajeni pak lodhjen. Bashkimi bën fuqinë dhe largon monotoninë.

AKREPI

Për shkak të Hënës kundër nga Demi, një dashuri e vjetër ndoshta kthehet në jetën tuaj, por tregohuni të vendosur: ka shumë mundësi që thjesht do humbisni kohë. Do jeni në qendër të vëmendjes në shoqërinë tuaj. Nga ju priten zgjidhje për të jetkuarur një vëzhërës.

SHIGJETARI

Venusit në kuadraturë me Saturnin: një person që më parë e keni gjykuar si pozitiv, në fakt do shfaqet sipërfaqësor dhe shumë pak interesant. Me Neptunin kundër, kini kujdes: mos u kushtoni shumë vëmendje propozimeve pak të besueshme.

BRICJAPI

Plutoni përkëdhel Hënën të Demi, duke krijuar një gjendje shpirtërore euforike që do ju lejojë të shprehni gjithë pasionin dhe dashurinë për partnerin tuaj. Do jeni në pozitën e duhur të fitonit besimin e tuaj të afërmi shumë kritik ndaj zgjedhjeve tuaja.

UJORI

Hëna të Demi nuk është në favorin tuaj, por sidoqoftë do arrini të përballoni dikë që përqipet të ndërhyjë shumë në jetën tuaj. Me Saturnin favorizues, përpikuni të gjeni kohë për veten tuaj për t'u çlodhur në qetësi.

PESHQIT

Falë Neptunit që kalon në shenjë, do keni dëshirë për emocione të forta dhe nevojën për të kaluar kohë me të dashurin e zemrës. Do fitoni vëmendjen e një personi që kishit krijuar një ide totalisht të gabuar për ju.

Dje në "Deutsche Welle"

Europa dhe lufta për shtresën e mesme

Christoph Strack

(vijon nga faqja 1)

... të modernizimit dhe mbështetësve të modernizimit". Kjo llinjë manifestohet në "copëzimin" e elektoratit. Shkencëtari është njëri nga autorët e një studimi për zgjedhjet në Bundestag, të cilin fondacioni Bertelsmann e paraqiti këtë të premte nën titullin "Zgjedhje popullore". Në të, ekspertët analizojnë me ndihmën e dy instituteve demoskopike 621 zona elektorale përfaqësuese në Gjermani dhe kanë pyetur mbi 10.000 gjermanë në ditët pas zgjedhjeve për sjelljen e tyre në votim.

AFD DHE MESI I SHTRËSËS SË MESME TË SHOQËRISË

Një rezultat i rëndësishëm: në luftë për mesin e shtresës së mesme të shoqërisë, AfD u bën konkurrencë para së gjithash partive unioniste. Në këtë mjedis, "Alternativa për Gjermaninë" si "parti e qartë populiste e djathtë" mori 20 për qind të të gjitha votave të zgjedhëse. Këto janë 14,6 pikë përqindje më shumë se në zgjedhjet e Bundestagut 2013. "AfD fitoi atje mbi mesataren vota", shprehet Christina Tillmann, drejtore e programit "E ardhmja e demokracisë" e fondacionit "Bertelsmann". Njëkohësisht, CDU dhe CSU patën rënie të dukshme në këtë ambient social të mesit të shtresës së mesme të shoqërisë. Me një rënie prej 15 për qind, humbja qe më e lartë



se në kampet e tjera shoqërore.

Vehrkamp është i pasigurt se çfarë do të thotë ky rezultat në plan afatgjatë për kampin unionist dhe ai bën krahasim me SPD. Socialdemokratët sot - dhe këtë e tregon

edhe rezultati i 24 shtatorit - nuk janë më një parti, "që ka një ambient social bazë" dhe një strukturë ambienti social në cilëndo formë gofë. Vehrkamp thotë se tani çështja është "nëse humbjet në ambi-

entet sociale do të marrin për partinë unioniste të njëjtën rrugë si ato të SPD në 15-20 vitet e fundit".

COPËZIMI

Një rezultat i dytë i rëndësishëm për shkencëtarët, rritja e pjesëmarrjes në votime në zgjedhjet për Bundestagun ka çuar "në një pakësim të ndjeshëm të copëzimit social". Kjo përshkruan hendekun midis një pjesëmarrjeje të madhe në zgjedhje dhe në lagje të forta nga pikëpamja ekonomike dhe sociale dhe një vlerë të ulët në lagje ekonomikisht të dobëta. Në vitin 2013, midis këtyre grupeve shoqërore dallimi ishte 29,5 për qind, kurse tani ishte 26,7 për qind.


Kjo rrudhje - thotë Christina Tillmann - duhet vlerësuar pozitivisht dhe është e "rëndësishme për demokracinë". Por, ajo formulon mbi këtë bazë një paralajmërim të qartë. Në Gjermani nuk duhet të ketë hapësira ose rajone "në të cilat, partitë e konsoliduara t'i pushojnë aktivitetet e tyre, ku të jenë zona të lira nga fushata elektorale".

Për rrudhjen është kujdesur edhe AfD, sepse ajo çoi në kutitë e votimit zgjedhës. Më shumë se 65 për qind e tyre janë skeptikë të modernizimit. Tjetër është çështja, nëse AfD - për ekspertët e fondacionit një parti "e qartë populiste e djathtë" - ka një program për këta njerëz. Demokracia ka gjithmonë "një fuqi të madhe integruuese", thotë Vehrkamp. Këtë ajo e ka dëshmuar herë pas here dhe duhet ta dëshmojë sërish.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

Fjalëkryqi (1)



- 37. Fillojnë detyrën.
- 38. Bektashi këngëtare.
- 39. Andrea aktore.
- 41. Sampras i tenisit.
- 43. Shkroi Korbi (indici).
- 44. Triolet e Trëndafilitë me kredi.
- 46. Kilmer aktor.
- 47. Në krye të robotëve.
- 49. Unë dhe ti.
- 50. Një mund të jetë fetar.
- 51. Stephane poet francez

VERTIKAL.

- 1. Fillojnë praktikën.
- 2. Britma e Arkimedit.
- 3. Ekstrema në trap.
- 4. Në fund të fundit.
- 5. Janë fjetoret e ushtarëve
- 6. Parker regjisor.
- 7. Vivaldi kompozitor.
- 8. Një shkop për karambol.
- 9. Janë firmat rentiere.

HORIZONTAL

- 1. Riza aktor.
- 7. Një fjalë si hiç.
- 11. Një mund të jetë diplomatik.
- 12. Premtori të bëhet as.
- 14. Janë felinë... të zinj.
- 16. Ami i Maupassant.
- 18. Heroi i Emilio Salgarit.
- 19. Qe anarkist i famshëm rus
- 21. Një mungesë gjaku.
- 22. Susanna shkrimtare
- 23. Të parat në cilësi.
- 25. Mbyllin një shtëpi.
- 26. Mbeten në fund.
- 27. Qendër në kaos.
- 28. Ka brrirë piktoreskë një i tillë
- 30. Inicialet e Camus.
- 31. Motra... e Kolë Idromenos
- 33. Një konfuzion total.
- 34. Rastet pa set.
- 36. Rastisin në krye.

- 10. Një i fundit mbi të gjithë
- 11. Kufizojnë tatimet
- 13. Janë nomadë.
- 15. Panik pa kufij.
- 16. Fryn detin
- 17. Sidney regjisori i Serpico.
- 18. Jep alarmin.
- 20. Fillojnë nazet.
- 24. Janë llogari.
- 25. Alan regjisor.
- 29. Roman regjisor.
- 32. Eshhtë X ajo e sulmit.
- 33. Kapen të parat.
- 35. Një provë... inteligjence.
- 37. Një markë lap top.
- 40. Fillojnë matjet.
- 41. Rruga e Ferenc Molnar.
- 42. Qerre pa qe.
- 45. Fillojnë lirinë.
- 46. Fillojnë vallen.
- 48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Një doktor... i Fritz Lang
- 6. U paraprinë hoteleve.
- 11. Kush nuk ka... nuk ha
- 13. Eshhtë djall
- 14. Një mund të ketë i rrallë.
- 15. Ishin perëndi të Samotrakias.
- 17. Institucione Botuese Autonome.
- 18. Eshhtë infeksion në bark
- 20. Fundi i një samurai.
- 21. Një markë kafeje.
- 22. Mbyllin një hark.
- 23. Mund të jetë emërore.
- 25. Ishte muzikanti që nuk përsiste.
- 28. Në krye të avokatëve.
- 29. Qerre pa qe.
- 30. Një pjesë e adoleshentëve.
- 32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.


VERTIKAL

- 1. James, armiku i Sherlock Holmes.
- 2. Eshhtë edhe ajo saudite.
- 3. Imami aktore
- 4. I kanë çift turket.
- 5. Inicialet e Seagal aktor.
- 6. Eshhtë dëshmore... çuditërisë.
- 7. Në fund të lutjes.




- 8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
- 9. Mbeten në fund.
- 10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
- 12. Conan ai i Schwarzenegger.
- 13. Gjysmë ditari.
- 15. Mario, që qe bomber argjentinas.
- 16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
- 18. Në hyrje të pistës.
- 19. Një numër... femrash.
- 21. Eshhtë qyteti i Besës
- 24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- 26. Njëllorj për latinët.
- 27. Mund të bëjnë stil të lirë.
- 31. Damon aktor.
- 33. Eshhtë pije e jona.
- 34. Në krye të noterëve.
- 36. Film i Robert Altman.
- 38. Skuadra merengue.
- 39. Një pjesë e hasmërisë.
- 40. Rralle është përgjysmë.
- 42. Nisur pa kufij.
- 45. Fillojnë mobilizimin.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8		4	6			7		3
			3	7				1
5				1	9	3		8
		1	5				4	
2		6				5		9
	9				7	3		
6			3	2	5			7
	5				6	9		
1		8			4	2		6

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	6	9	1	3	5	2	8	7
1	7	5	2	9	8	6	4	3
8	3	2	7	6	4	1	9	5
9	5	8	4	1	3	7	2	6
3	4	7	6	8	2	5	1	9
6	2	1	5	7	9	8	3	4
7	8	4	9	5	1	3	6	2
2	1	6	3	4	7	9	5	8
5	9	3	8	2	6	4	7	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "Një mik i vërtetë është shumë e vështirë që të gjendet, shumë e vështirë që të largohet, dhe është e pamundur që të harrojë".
- "Disa herë, akoma dhe gjërat më të parëndësishme do të mund të ishin gjëra të jashtëzakonshme, nëse do t'i bënim me njëzëitë e duhur".

Elizabeth Green

- "Të mund të fësh i qetë, të mund të duash dhe të mbash mend se këtu jemi të gjithë kalimtarë".

Jorge Luis Borges

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	11	7	2		1	11	2	7			
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2		
	1		12	4	2	12	4	11		6	1	8		
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2			
3			5	10	3	1	14	4	6	1				
4	12	2	5	1	7	2	12		11	4	3			
7	10	6	10	14	4	8		12	10	7	4			
12	11	1	9	4		12	6		8	15	8			
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14		
7	2	14	4	12			K	W	O	P	S	H	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12		

E L E K T R I K K U R A
T E R R E N I K A N A L
I R M A F O N I K E
K A V I K T I M A T K
A M A R R E Z I T E S
M E T E O R I T E T Z
R O M A N T I K E T Z N
E N E D A T T K O D
C I C E L A I K O N E
E T E R O L A Z A R
T O E A F A T A L
A R K I V A T D A K E T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	T	E	T	K	A	M	P	U	L	A	
R	E	A	L	T	A	H	A	R	R	I	S	
O	R	K	P	E	R	S	N	K	N	P		
M	A	T	H	E	R	R	I	M	E	T	D	I
A	K	E	S	M	E	R	I	K	O	R		
T	U	R	H	A	M	E	S	R	R	A		
S	E	C	I	L	I	N	M	O	T	E	T	
M	A	D	A	M	E	A	K	O	M	A	A	
I	R	O	N	I	A	T	O	M	E	T	T	
T	I	N	A	B	L	E	O	I				
E	A	H	A	L	I	L	E	S	A	M		
T	D	I	A	N	A	N	T	E	N	A		

FJALËKRYQI (1)

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	A	K	I	C	A	P	A	L	L	A	T	E
R	U	D	E	R	A	H	E	R	E	T		
O	I	L	P	R	R	P	T	I	M	O		
V	O	L	A	M	A	T	O	R	I	P	N	
K	E	S	A	T	I	R	E	T				
K	E	V	A	S	H	A	T	B	E	L	A	
A	T	L	N	E	K	A	R	R	A	P		
T	A	R	I	S	E	H	A	R	K	U		
O	R	T	A	K	E	T	B	M	E	R		
R	O	A	Q	E	V	E	R	T	A	N	O	T
E	M	U	T	E	M	E	Z	E	R	O		
T	A	P	A	N	E	L	L	E	N	T	I	M

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Jemi ajo që mendojmë.
- Eshhtë e nevojshme që njeriu t'i afrohet gjithmonë e më shumë të mirës e të përpiqet të ruajë mendjen e tij nga ligësitë. Mendja e atij që bën vepra të mira me gjysmë zemër, në fakt, merr kënaqësi në të keqe.
- Sa më pak të keni, aq më pak duhet të shqetësoheni.
- Dhimbja e nxit njeriun të mendojë. Mendimi e bën njeriun të mençur. Mençuria e bën jetën të lehtë.
- Prej njëqind sëmundjeve, pesëdhjetë shkaktohen nga gabimet tona e pesëdhjetë të tjera nga mosdija jonë.
- Irlandezë: Ji i lumtur me çfarë ke, do të shohësh se ke përse të jesh i lumtur.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

